



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
“Marketing Dixhital”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan  
Tirana”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Klodiana GORICA

2. Prof. Asoc.Dr. Vita KOJA

Nëntor, 2020

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **Master Profesional në “Marketing Dixhital”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Metropolitan Tirana
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Administrative
3	Emërtimi i programit të studimit:	Marketing Dixhital
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 706, Dt. 19.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cili i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 Vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10/7
18	Numri i studentëve:	8
19	Komente / të tjera:	



# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës

Programi i Studimit “Marketing Dixhital” përbën një inovacion jo vetëm për Universitetin Metropolitan Tirana që e ofron, por për të gjithë tregun e arsimit të lartë shqiptar, si publik ashtu edhe privat. Disa specifika teknike të përgjithshme referuar këtij programi studimi janë si më poshte:

- Ky program studimi është lejuar të ofrohet për here të parë nga Universiteti Metropolitan Tirana në vitin akademik 2018-2019;
- Ky program studimi është aktivizuar në vitin akademik 2019-2020;
- Ky program studimi është licensuar me Urdherin e Ministrisë së Arsimit Nr.706, datë 19.10.2018, bazuar në Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së Nr 317, datë 20.02.2019;
- Ky program studimi ka kohëzgjatje 1 (nje) vit, me 60 kredite ECTS, gjuha e studimit është shqip.
- Ofrohet në shqip, por disa kurse jepen edhe në anglisht për shkak të pedagogëve të huaj.

Ky program studimi përbën një pike të fortë jo vetëm për Fakultetin e Ekonomisë që e ofron, por për të gjithë Universitetin Metropolitan, prandaj rritja dhe përmirësimi cilësor si dhe mbajtja e standardeve të larta në të ardhmen përbën një sfidë jo vetëm për këtë program studimi. Ky program fare mirë do të mund të rrisë dhe përmirësojë imazhin dhe reputacionin e të gjithë Universitetit Metropolitan Tirana në të ardhmen. Vendodhja gjeografike dhe pozicionimi në një zonë studentore, mundëson qasjen pranë një tregu më të madh të synuar. Tregu aktual ndërkombëtar dhe kombëtar dikton rritje të nevojave për diploma të tilla në treg si dhe tendencat e punësimit në rritje edhe për tregun shqiptar janë tregues mbështetës për sa më lart.

Në të gjithë dokumentacionin që lidhet me objektivat, strategjitë dhe vendimet e këtij programi studimi citohet qartë se ky program studimi hartohet dhe ofrohet bazuar në misionin dhe qëllimet e këtij institucioni.

Misioni i Universitetit Metropolitan Tirana është ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera. Programi i studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital” është pjesë integrale e programeve të studimit të nivelit të dytë që ofron Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit Metropolitan Tirana. Ky program ofrohet nga një prej 3 departamenteve që ka ky fakultet dhe konkretisht nga Departamenti i Shkencave të Administrimit, i cili është departament i konsoliduar dhe me një staf pedagogjik të jashtëm e të brendshëm cilësor duke u konsideruar si garant për plotësimin e standardeve të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Në të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UMT, shpejgohen qartë dhe në mënyrë të detajuar qëllimet e programit, objektivat e tij, të cilat përputhen plotësisht me nevojat për punësim, kërkesat e tregut të synuar, apo nevojat dhe mbështetjen që UMT i bën biznesit vendas përmes këtij programi.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Në datën 24.10.2019, Universiteti Metropolitan Tirana ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master Profesional në "Marketing Dixhital". ASCAL bazuar në "Manualin për procedurat.....", përzgjedhi dy vlerësues të jashtëm të cilët bazuar në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) të programit të studimit Master profesional në "Marketing Dixhital" të Universitetit Metropolitan Tirana dhe në vizitat e kryera në UMT, kanë hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Marketing Dixhital".

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet Prof. Dr. Klodiana GORICA dhe Prof. Asoc.Dr. Vita KOJA. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Erjon Xhako.

Ne datën 10.07.2020, GVJ-së ju vu në dispozicion i gjithë dokumntacioni i dorëzuar nga UMT (DVV), pas shqyrtimit të këtij dokumntacioni nga GVJ, u hartua dhe agjenda e vizites në institucion, e cila u zhvilluan në datë 22 dhe 23 Shtator.

Gjatë vizitave ekspertëve ju vendos në dispozicion një sallë e dedikuar për të kryer takimet e planifikuara sipas agjendës. Ndërkohë që u kërkua dhe dokumentacion shtesë i cili ju vu në dispozicion GVJ.

Bazuar në DVV, në intervistat me pyetje të përcaktuara të GVJ, siasp fokus grupeve të përcaktuara në agjende, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm paraqet Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit Master Profesional në "Marketing Dixhital", sipas standardeve dhe kritereve të përcaktuar për programet master profesional. Në përfundim të këtij Raporti, paraqitet në forme të përmbledhur një analizë përfundimtare mbi programin e studimit Master Profesional në "Marketing Dixhital", si dhe rekomandimet përkatëse për institucionin.

Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm u dërgua në institucion me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare nr. 18/18 Prot. datë 27.10.2020. Institucioni ka kthyer përgjigje mbi Draft Raportin, më datë 03.11.2020, me anë të sistemit AMS, duke u shprehur se nuk ka komente mbi Draft Raportin, si rrjedhojë Draft Raporti merr formen e tij finale në, Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Marketing Dixhital”

### I. OFRIMI PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital” është licensuar sipas UMASR Nr. 706, date 19.10.2018. Ky program studimi është aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2019-2020 dhe ky është brezi i parë i studenteve që janë formuar në këtë program.</p> <p>Bazuar në dokumentacion, por edhe nga takimi me drejtuesit e njësisë bazë dhe në nivel fakulteti, rezulton se misioni i Universitetit Metropolitan Tirana është ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera.</p> <p>UMT e ka të shprehur qartë në të gjithëdokumentet strategjike qëllimet dhe objektivat specifike, të cilat në totalin e tyre rezultojnë në mbështetjen e programeve të studimit, në dhe për interesa kombëtare, sikurse edhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i> <i>Takimi me zv dekanin dhe drejtuesin e departamentit të Shkencave të Administrimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Në të gjithë dokumentacionin që lidhet me objektivat, strategjitë dhe vendimet e këtij programi studimi citohet qartë se ky program studimi hartohet dhe ofrohet bazuar në misionin dhe qëllimet e këtij institucioni.</p> <p>Programi i studimit MP në “Marketing Dixhital” është pjesë integrale e programeve të studimit të nivelit të dytë që ofron Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit Metropolitan Tirana. Ky program ofrohet nga një prej 3 departamenteve që ka ky fakultet dhe konkretisht nga Departamenti i Shkencave të Administrimit, i cili është departamenti konsoliduar dhe me një staf pedagogjik të jashtëm e brendshëm cilesor duke u konsideruar si garant për plotësimin e standardeve të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe i</p>




	<p>specialistëve cilësorë në aspektet teorike dhe veçanërisht në aftësimin praktik të tyre për studimin dhe shitjen në tregje të ndryshme, përdorimin e instrumenteve dixhitale në teknikat dhe instrumentet e marketingut, promocionit, reklamave, komunikimit, politiken e çmimeve të shpërndarjes etj.</p> <p>Bazuar ne takimin dhe komunikimin nëinstitucion, sipas drejtuesve të këtij institucioni, Fakulteti i Ekonomisë në UMT është një fakultet i cili menaxhon 9 programe studimi dhe me nje rritje në mënyrë graduale sikurse edhe me një staf akademik të kualifikuar, qoftë ky i brendshëm apo i jashtëm.</p> <p><i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i>  <i>Mendim i Dekanit te FE per hapjen e programit te studimit Master Professional ne "Marketing Dixhital"</i>  <i>Takimi me zv dekanin.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Ne fakt, misioni i çdo institucioni të arsimit të lartë lidhet pikërisht me ofrimin e programeve të tilla studimi që të mbulojnë nevojat lokale apo rajonale sikurse edhe ato kombëtare. Me këtë qëllim dhe me objektiva të mëtejshme specifike është krijuar dhe mbart misionin e vet në rrugëtimin drejt dijes edhe Universiteti Metropolitan Tirana.</p> <p>Ky universitet dallohet veçanërisht për ofrimin e programeve të tilla studimi që janë të specializuara dhe kufizuara në ato degë që ka kërkesa tregu. Nga ana tjetër, në perceptimin e GVJ, rritja dhe zgjerimi i kujdesshem dhe i studiuar mirë nga ekspertet brenda Universitetit Metropolitan Tirana, përgjate 10 viteve të ekzistences së tij ka prodhuar jo vetëm qëndrueshmëri të programeve nëpërgjithësi, por dhe imazh cilësor,veçanërishtpër tregun vendas.Në këtë menyre eshte tashme i krijuar me kujdes emri i mire ne ofrimin e programeve të studimit. Kjo do të thotëqe edhe ofrimi i ketij programi studimi, që në nisje paragjykohet si pozitiv, nëvazhdën e programeve të tjera. Nga ana tjetër, lista e madhe e marrëveshjeve tëbashkëpunimit sikurse edhe numri i konsiderueshem i universiteteve ndërkombëtare me të cilat UMT bashkëpunon duke prodhuar produkte cilesore si qendra apo inkubatore, janë tregues sasiore dhe cilesore të përmbushjes së këtij kriteri, pra të hartimit dhe ofrimit të këtij programi nëpërputhje me interesat kombëtare dhe nëmbështetje të tyre.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i>  <i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i>  <i>Evidenca 22:Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf</i>  <i>Evidenca 23:Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>




<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Strategjia e Zhvillimit të Universitetit Metropolitan Tirana, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 224/1 Prot., date 08.04.2019 specifikon se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> <p><i>“UMT përbën një institucion cilësor, të kujdesshëm në rritje dhe zgjerim të programeve të studimit dhe të fokusuar në të qenurin inovativ”.</i></p> <p>Një ndër misionet e UMT, lidhet me thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të studentëve në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë, etj, duke ofruar mundësi të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i>  <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i>  <i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i>  <i>Mendim i Dekanit të FE për hapjen e programit të studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi Master Profesional në “Marketing Dixhital” jep një kontribut të rëndësishëm në zhvillim dhe mbështetjen e vlerave kombëtare në fushën akademike dhe profesionale. Kjo mbështetet edhe në marrëveshjet e bashkëpunimit, përpjekjet e programit për të qënë sa më inovativ dhe nxitur sipërmarrjen.</p> <p>Programi i studimit MP në “Marketing Dixhital” është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu siç paraqitet në statutin dhe strategjinë e UMT. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit, e transmetimit të dijeve, në pajisjen me aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t’u bërë ekspertë e profesionistë të denjë të fushës së marketingut dixhital. Referuar RVB, institucioni, në strategjinë e tij ka të përcaktuar qartë ofertën dhe drejtimit akademike që ofron në drejtimit e shkencave aplikative inxhinierike (teknologji informacioni, shkenca teknike), në ndërtimtari (ing. ndërtimi arkitekture), shkenca ekonomike dhe menaxheriale (finance, administrim, informatike ekonomike).</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i>  <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i>  <i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i>  <i>Evidenca 22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf</i>  <i>Evidenca 23: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

7

	<i>Evidenca 53: Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf</i> <i>Tabela 9: Plani mesimor i ndare sipas veprimtarive formuese.pdf</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>Sikurse u përmend edhe me lart, UMT në strategjinë e tij ka të përcaktuar qartë ofertën dhe drejtimit akademike që ofron në drejtimit e shkencave aplikative inxhinierike (teknologji informacioni, shkenca teknike), në ndërtimtari (ing. Ndërtimi arkitekture), shkenca ekonomike dhe menaxheriale (finance, administrim, informatike ekonomike). Pra, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit MP në “Marketing Dixhital” ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p> <p>Objektivi kryesor i këtij programi studimi është të formojë ekspertë dhe specialist cilesorë në aspektet teorike dhe veçanërisht në aftësimin praktik të tyre për studimin dhe shitjen në tregje të ndryshme, përdorimin e instrumenteve dixhitale në teknikat dhe instrumentete marketingut, promocionit, reklamave, komunikimit, politiken e çmimeve dhe tëshpërndarjes, etj.</p> <p>Madje, në mbështetje tëplotësisht të këtij kriteri, duhet thënë se ky universitet dallohet veçanërisht për ofrimin e programeve të tilla studimi qëjanë të specializuara dhe kufizuara në ato degë që ka kërkesa tregu, është konsideruar nga nje rritje dhe zgjerim i kujdesshem dhe i studiuar mire nga ekspertët brenda universitetit. Kjo rritje e kujdesshme, e mirestudiuar, përgjatë 10 viteve të ekzistencës së UMT, ka prodhuar jo vetëm qëndrueshmëri të programeve në përgjithësi, stabilitet dhe imazh cilësor veçanërisht, për tregun vendas. Në këtë menyre është tashme i krijuar emri i mirë në ofrimin e programve të studimit. Kjo do të thote, edhe ofrimi i ketij programi studimi që në nisje paragjykohet si mjaft pozitiv në vazhden e programeve të tjera.</p> <p><i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i> <i>Evidenca 21:Lista e programeve të studimit që ofron Universiteti Metropolitan Tirana.pdf</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	<p>Universiteti Metropolitan Tirana (UMT) është institucion privat, laik i arsimit të lartë me karakter mësimor e shkencor. UMT aspiron formimin e specialisteve e sipërmarrësve të së ardhmes duke krijuar, transmetuar e zhvilluar dijet nëpërmjet procesit të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.3

**Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

8



**dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Bazuar në <i>Evidencen 76:Minuta të mbledhjeve të Dekanatit.pdf</i>, është cituar dhe rekomanduar edhe nga drejtuesi i Fakultetit të Ekonomisë, Prof. Dr. A.C, në fund të kësaj mbledhjeje ajo ç’ka pikërisht evidentohet edhe nga dokumentacioni, por edhe nga vizita dhe diskutimet me drejtuesin e departamentit dhe stafin e këtij departamenti se: <i>“Departamentet si njësi bazë duhet të marrin rolin e tyre në nivele manaxheriale, bazuar kjo si në ligjin e arsimit të lartë, ashtu edhe në statusin e UMT apo rregulloren e tij”</i>.</p> <p>Gjykojmë se kjo në fakt ngarkon drejtuesin e departamentit por edhe stafin e brendshëm për një mbarëvajtje dhe përditësim cilesor të vazhduar të kurrikulave, jo vetëm bazuar në llojin e masterit (sepse tema e marketingut dixhital është e ndjeshme dhe e ndryshueshme), por edhe përpërshtatjen me nevojat e tregut, të biznesit dhe vetë studentëve, por edhe për të vijuar të qenurit lider në këtë program masteri. Institucioni bën përpjekjet e duhura për të ofruar programe studimi që janë në përputhje me tregun e punës, sikurse mbështet studentët drejt hapjes së start up-eve apo punësimit të tyre. Kjo është bazuar jo vetëm në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, por edhe nga vizita në terren dhe takimet me studentët.</p> <p><i>Evidenca 53:Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf, pika 2</i> <i>Evidenca 76:Minuta të mbledhjeve të Dekanatit.pdf</i> <i>Evidenca 58:Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Ky program studimi vjen si pasojë e ofrimit nga UMT prej një dekade të shkencave informatike dhe inxhinierike, nga UMT hapja e një programi të tillë studimi është konsideruar si një kalim “i bute” drejt shkencave të manaxhimit dhe marketingut përse kohë ka një qasje edhe dixhitale/informatike.</p> <p>Kjo vjen si pasojë e “pjekjes së kushteve” dhe krijimit të mundësive nga UMT për ta hapur këtë program, jo se nuk ka qenë në idetë dhe orientimet e kahershme të drejtuesve. Kjo sepse inxhinieria dhe ekonomiku janë orientimet kryesore të UMT.</p> <p>Punësimi aktual i studentëve që janë në proces të këtij programi studimi është konsideruar mjaft pozitiv dhe optimist për të ardhmen. Pedagogët e jashtëm dhe të “huazuar” kryesisht nga FEUT është konsideruar si pikë e forte. Ndërkohë pritshmëritë janë optimiste për drejtuesit e këtij institucioni, dhe veçanërisht të departamentit, argumentimi i tyre bazohet jo vetëm në faktorët e mësipërm por edhe në kërkesën dhe tendencën ndërkombetare në rritje të marketingut dixhital. Në takimet e zhvilluara fizikisht në ambientet e UMT, studentët, stafi i brendshëm dhe i jashtëm, drejtuesi i departamentit dhe zv dekanit, u shprehën mjaft pozitivisht dhe mbështetës për të ardhmen.</p> <p>Ndërtimi i një programi të tillë mesimor, pra marrja e idese për hapjen e këtij masteri është bazuar në parjen e tendencës në rritje për aftësi dixhitale dhe marketing, të kërkuara në tregjet ndërkombetare. Në këtë mënyrë, në kuader të karakterit inovativ që ka treguar e gjithë politika dhe qasja e UMT, është konsideruar si vijimësi e rrugetimit inovativ</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

9

<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>hapja e një masteri në Marketing Dixhital.</p> <p>Është pranuar edhe nga drejtuesi i departamentit se materiali i vënë në dispozicion të ekspertëve të jashtëm të këtij akreditimi nuk përbën një studim të mirëfilltë tregu, por një përmbledhje dhe konsideratë të përgjithshme të argumentimit dhe opinionit për të hapur një program të tillë studimi. Kjo do të thotë se studimi i tregut i bashkangjitur në DVV në vetvete nuk:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përbën një studim të konkluduar mbi bazën e një studimi/kerkimi sasior;</li> <li>• Përbën një analizë të opinionëve të detajuara të bizneseve kryesore të këtij shërbimi në tregun shqiptar;</li> </ul> <p>Sikurse u diskutua intensivisht edhe me grupin e vleresimit të brendshëm në ambientet e UMT, rezulton se nga stafi i brendshëm është bërë një analizë cilësore e disa kurrikulave ndërkombëtare dhe një ballafaqim intensiv me këto kurrikula. Kjo gjë është bërë në fakt jo vetëm nga pedagogët që japi lëndët specifike, por në një kuadër më të gjërë që i ka shërbyer direkt ndërtimit të kurrikules.</p> <p>Gjatë takimit me drejtuesit e fakulteti dhe departamentit që ofron programin e studimit MP në “Marketing Dixhital”, u afirmua nga dy palët nevoja për përmirësim të planit mësimor dhe disa syllabuseve. Nevoja për përmirësim jo vetëm për këtë program të ri studimi që ofrohet për herë të parë, por dhe për të gjithë programet e studimit që ofron UMT, është një proces periodik i vazhdueshëm, për të garantuar përditësimin në kohë me kërkesat e tregut të punës, me literaturë të përditësuar, me të reja shkencore apo aplikative të fundit etj. Vetë institucioni, në përputhje dhe me kuadrin ligjor (neni 35, LAL 80/2015) ku përcaktohet se përmirësimet e mundshme të planit dhe elementëve të tij bëhen pas fazës së testimit të programit aktual, ka filluar punën për analizimin në kuadër të përmirësimit të planit të studimit, ku sugjerimet e GVJ, u gjetën me shumë vend për t’u reflektuar për vitin e ardhshëm akademik, me qëllim ofrimin sa më cilësor të dijeve dhe të koncepteve.</p> <p>Në këtë mënyrë, programi mësimor i rishikuar mbi këtë analizë, do të mund të përfshijë dhe përgjigjet një tregu më të gjërë dhe do të synojë edhe studentë të nivelit bachelor të degëve të tjera si juridik, gjuhë e huaj, gazetari, shkenca sociale, shkenca të natyrës, etj, segmente të cilat do të mund të synohen lehtësisht përmes një kurrikule të përditësuar dhe përshtatur për të gjithë, me apo pa njohje në marketing.</p> <p>Nëse do të ishte bërë një studim sasior i detajuar tregu, i bazuar edhe në intervista të thelluara me njohës dhe opinionist të fushës sikurse edhe sipërmarrës të bizneseve të lidhura me temën, disa prej këtyre përmirësimeve do të ishin të panevojshme. Gjithsesi e konsideruar si hap i parë dhe inovativ, sikurse edhe komoditeti i të qënurit lider në këtë program studimi, mundeson lehtësisht çdo përmirësim të mundshëm të kurrikulës në të ardhmen për të siguruar një produkt cilësor dhe po aq inovativ të UMT.</p> <p><i>Evidenca 74: Studim tregu për programin.pdf</i>  <i>Evidenca 88: Plani i Marketingut UMT.pdf</i></p>
---	--

	<p><i>Takim me drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit</i></p> <p><i>Takim me NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Përgjatëtakimeve në institucion u konstatua një përjasje e fortë dhe nevojë e përafrit me kurrikulat ndërkombëtare. Pavaresisht sugjerimeve dhe konstatimeve të bëna re edhe nga dokumentacioni apo vizita në lidhje me studimin e tregut, u identifikua se stafi i brendshëm (veçanërisht), por edhe ai i jashtëm bejnë një punë të përpjekur dhe cilësore personale drejt përmirësimit të vazhdueshëm të lëndëve që ato ofrojnë dhe metodave mësimdhënëse dhe mësimnxënëse. Pas vizitës në institucion, me kërkesë të grupit të vlerësimit të jashtëm, u vu në dispozicion nga UMT një listë e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare të konsultuara. Arsye për këtë kërkesë shpjegohen në rubrikën lidhur me syllabuset, por për të mbështetur këtë kërkesë në plotësim të këtij kriteri, duhet thënë se kjo kërkesë u bazua në identifikimin nga GVJ të nevojës për të përmirësuar përbërjen dhe llojet e lëndëve brenda këtij programi studimi.</p> <p>Bazuar në dokumentin e sjellë pas vizitës nga institucioni vihet re një larmshmëri e institucioneve ndërkombëtare të konsultuara. Institucioni falë bashkëpunimit që ka me institucionet, kompanitë e ndryshme apo angazhimit të stafit të kualifikuar të këtyre organizatave në procesin e mësimdhënies të ftuar, të punësuar në kompanitë apo sektorët dixhital merr vazhdimisht informacione mbi nevojat e tregut të punës dhe përmirësimin e programeve.</p> <p><i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i>  <i>Evidenca 74: Studim tregu për programin.pdf</i>  <i>Evidenca 88: Plani i Marketingut UMT.pdf</i>  <i>Lista e kurrikulave të konsultuara për hartimin e kurrikules së programit Master Profesional Marketing Dixhital</i>  <i>Tabela 5: Institucionet dhe oraganizatat bashkepunuese në rang programi për praktikant profesional.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disave vjeçare të institucionit dhe praktikant e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Referuar DVV dhe RVB, ky program është i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin udhëzues të BE për arsimin e lartë, si dhe në eksperiencën disa vjeçare që ka UMT në ofrimin e programeve të ciklit të dytë, duke u bazuar në tendencën e kërkesave të tregut Europian dhe rajonal. <a href="https://ec.europa.eu/education/">https://ec.europa.eu/education/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>UMT ka një profil të lartë kombëtar dhe ndërkombëtar për sa i përket bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel institucional. Referuar strukturës së programit të studimit, aftësitë profesionale studentëve iu ofrohen nëpërmjet formave të mësimdhënies me orientim praktik (detyra kursi), punë laboratorike, ushtrime në klasë, studime rasti, zgjidhje situatash, si dhe kryesisht nëpërmjet praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidenca 23: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mesimor sipas llojit të veprimtarisë.pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregulloret e programit të studimit.pdf</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

11

	<p><i>Evidenca 72:Lista e lektorve të huaj dhe e aktiviteteve FE.pdf</i>  <i>Tabela 2:Personeli Akademik sipas njesive.pdf</i>  <i>Tabela 5: Institucionet dhe oraganizatrat bashkepunuese ne rang programi per praktikat profesionale.pdf</i>  <i>Tabela 10:Plani mesimor.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Bazuar ne takimin e zhvilluar ne institucion, si me GVB ashtu edhe me stafin e këtij programi, u identifikua se disa lëndë jepen edhe në gjuhën angleze, përpos faktit që pothuajse e gjithë literatura e përdorur është ne anglisht. Kjo u identifikua edhe nga takimi me studentet te cilët e gjenin relativisht të lehtëpërdorimin e gjuhës angleze në këtë program studimi, kjo mbase edhe sepse vetë specifika e këtij programi dhe rrjedhimisht e lëndëve të zhvilluara brenda tij, apo edhe e lëndëve që do të mund të shtohen apo modifikohen në të ardhmen, është e tillë që është ndërkombëtare dhe rrjedhimisht e lehtëson në të ardhmen jo vetëm ndërkombëtarizimin e këtij programi por edhe ofrimin e tij mbase totalisht në gjuhën angleze.</p> <p><i>Evidenca 56:Plan programet e lendeve.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Nga takimi me stafin dhe GVB rezultoi se kërkesa për profesionistë të marketingut dixhital, është relativisht në rritje ne nivele ndërkombëtare dhe rrjedhimisht edhe në vendin tonë, për shkak të zhvillimit dhe evoluimit masiv dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit për efekte te marketingut te produkteve dhe/ose shërbimeve, si dhe të situatës të pandemisë, që ka kushtëzuar përdorimin në shkallën maksimale të teknologjisë së informacionit. Kërkesa e lartë për të kualifikuar me këto kompetenca në gjykimin tonë, mund të plotësohet dhe mundësohet në vijimësi përmes UMT dhe këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca 53:Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 56:Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Takimi mestafin akademik dhe GVB</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UMT përmes hapjes së këtij programi studimi ka demonstruar qasjen inovative të tij të treguar në mënyrë të kahershme prej një dekade. Përvoja dhe përqendrimi në orientime të specifikuar qartë dhe të fokusuar përgjatë viteve në këto drejtime, analiza e detajuar që ka treguar UMT për zgjerimin përmes programeve të reja ka demonstruar profesionalizëm dhe rritje të qëndrueshme. Kapacitetet infrastrukturore të bollshme dhe të plota, me drite, sipërfaqe dhe</p>

	<p>organizim teknik të kujdesshëm, perkujdesi në përzgjedhjen e stafit të jashtëm, cilësia dhe kualiteti i stafit të brendshëm tregon vëmendjen e këtij institucioni në rritje cilësore të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca 53: Te dhena të përgjithshme për programin e studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mesimor.pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregulloret e programit të studimit.pdf</i>  <i>Tabela 1: Numri i personelit Akademik për çdo njësi baze.pdf</i>  <a href="https://ec.europa.eu/education/">https://ec.europa.eu/education/</a>.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi MP në “Marketing Dixhital” është i hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe kuadrin udhëzues të BE për arsimin e lartë, si dhe në eksperiencën disa vjeçare që ka UMT në ofrimin e programeve të ciklit të dytë, duke u bazuar në tendencën e kërkesave të tregut evropian dhe rajonal. Kjo analize mbështet faktin se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Programi i studimit MP në “Marketing Dixhital”, ofrohet duke pasur parasysh kushtet e reja që dikton nevoja e zhvillimit të vendit sidomos në drejtim të teknologjisë së informacionit dhe IT-se. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në marketing i shërben zhvillimit të sektorit të marketingut jo vetëm në rang kombëtar, por edhe rajonal dhe më gjerë sepse krijohet mundësia për studimin dhe ndërhyrjen në tregje shumë më të gjera se sa në kushtet e marketingut të zakonshëm.</p> <p><i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i>  <i>Evidenca 74: Studim tregu për programin.pdf</i>  <i>Evidenca 88: Plani i Marketingut UMT.pdf</i>  <i>Lista e kurrikulave të konsultuara për hartimin e kurrikules së programit Master Profesional Marketing Dixhital</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	NA			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

### Standardi I.5

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

13

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe referimi tek ndërkombëtarët, apo e gjithë qasja ndërkombëtare përben nje instrument që mbështet inovacionin e këtij programi studimi në vijueshmërinë e rrugetimit sipërmarrës dhe inovativ të UMT. Po kjo qasje dhe organizim ekziston edhe brenda institucionit me struktura të mirëorganizuar dhe funksione specifike përgjegjëse ku secila është përgjegjëse për të realizuar analizën dhe vazhdueshmërinë specifike për secilin funksion.</p> <p><i>Evidenca 53: Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise.pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Tabela 5: Institucionet dhe oraganizatat bashkepunuese ne rang programi per praktikat profesionale.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>UMT-ja ofron programe studimi në përgatitjen e profesionistëve në fushën e ekonomisë, financës, menaxhimit, në fushën e arkitekturës dhe ndërtimit si dhe në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inxhinierisë informatike, me qëllim që të ofrojnë njohuri dhe kompetenca dhe t’i praktikojnë ato në tregun e punës dhe të kërkimit shkencor, duke i çuar më përpara ato fusha dhe disiplina shkencore.</p> <p><i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i></p> <p>Fakulteti i Ekonomisë ndjek me kujdes dhe ka nënvëzhgim dhe analizim të vazhdueshëm tregun epunës, duke e ndjekur atë në sektorë të ndryshëm dhe në rajone të ndryshme. Një instrument tjetër janë bashkëpunimet që UMT ka me institucionet dhe kompanitë e ndryshme. Angazhimi i stafit të kualifikuar të këtyre organizatave në procesin e mësimdhënies, mundëson që institucioni të marrë vazhdimisht informacione mbi nevojat e tregut të punës. Siç është cituar dhe më lart, përafrimi i programeve të studimit me ato të ofruara në universitete të tjera është fakt në këtë institucion. Konkretisht për programin e studimit MP në “Marketing Dixhital”, na u vunë në dispozicion pas vizitës në vend, kurrikula të konsultuara të universiteteve të tjera, duke sjellë një përjasje të konformitetit të kurrikulës së këtij programi me ato të vendeve të tjera, e për pasojë mundësi të larta transferimi studimesh apo punësimit të të diplomuarve dhe në nivel ndërkombëtar.</p> <p>Gjatë takimit me titullarët e fakultetit u inkurajua nga GVJ për këtë program studimi, mbajtja në vazhdimësi e kontakteve me bizneset më të mëdha në vend që ofrojnë shërbime të tilla, në këtë mënyrë do të mundën më mirë e më shpejt të përditësojnë syllabuset, lëndët që ofrojnë dhe integrojnë praktikatat më të mira vendase dhe të miksojnë ato me literaturat e situatave ndërkombëtare. Në këtë mënyrë ky</p>

	<p>departament/fakultet do të mbajëndezur karakterin inovativ të këtij programi studimi duke e garantuar këtë fakt edhe për të ardhmen, duke patur në konsideratë që është vetëm viti i parë i ofrimit të këtij programi.</p> <p><i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT.pdf</i>  <i>Evidenca 74: Studim tregu per programin.pdf</i>  <i>Tabela 4: Ngarkesa totale e personelit akademik te programit ne 1 vit akademik.pdf</i>  <i>Tabela 5: Institucionet dhe oraganizatat bashkepunuese ne rang programi per praktikat profesionale.pdf</i>  <i>Takimi me titullarët e Fakultetit,</i>  <i>Takimi me stafin akademik dhe me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Studentet e këtij programi studimi në momentin e kryerjes së vizitës në institucion për akreditimin e këtij programi, ende nuk ishin diplomuar. Kjo është argumentuar nga drejtuesit e departamentit se i është dhënë kohë sikurse ka qënë edhe në dëshirën e studentëve të përgatiten cilësisht për diplomën, apo të realizojnë mirë dhe përfitojnë të gjithë dijet praktike përmes lëndës së fundit të këtij programi: <i>praktika.</i></p> <p>Kjo lëndë ka një numër të madh orësh, kredite të konsiderueshme, duke i dhënë peshën dhe rëndësinë e duhur. Përpos faktin që elementi praktikë është mjaft i rëndësishëm për specifikën që ka ky program studimi. Nga i gjithë dokumentacioni u vu re se është i proceduar mirë si element i rëndësishëm i programit, studentët plotësojnë formularë, udhëhiqen nga pedagogu përkatës, mbajnë kontakte të vazhduara dhe periodike edhe me pjesën tjetër të departamentit apo drejtuesin e tij në raste nevojash, këshillimi, etj. Këto sa më lart u identifikuan edhe përgjatë diskutimit me studentët në takimin e patur me ta.</p> <p><i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Evidenca 124: Dokumentacion i praktikës per programin e studimit.pdf</i>  <i>Tabela 5: Institucionet dhe oraganizatat bashkepunuese ne rang programi per praktikat profesionale.pdf</i>  <i>Takimi me studentet</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>UMT fton dhe ka qasje ndëraktive për pedagogët apo bizneset e ftuara. Kjo përben një mënyrë për të sjellë të reja të fushës. Kjo gjë u diskutua dhe në takimin fillestar me drejtuesit e institucionit. Këta studentë ende nuk janë diplomuar por qasja është pozitive për të ardhmen në funksion të plotësimin të këtij kriteri.</p> <p><i>Evidenca 72: Lista e lektorve të huaj dhe e aktivitetëve FE.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e</p>	<p>Analizat periodike janë shembull i mirë dhe i kujdesshëm, ndërkohe që vihen re edhe analiza jo formale përmes mbledhjeve të thirrura nga drejtuesit e njësive të bazës. Diskutimet midis stafit të brendshëm dhe jashtëm janë ndëraktive, ka qasje kritike dhe mbështetëse, në këtë sens</p>




bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	dhe plotësim të këtij kriteri. <i>Evidenca 72: Lista e lektorve të huaj dhe e aktiviteteve FE.pdf</i> <i>Evidenca 73:Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar FE.pdf</i> <i>Evidenca 124: Dokumentacion i praktikës për programin e studimit.pdf</i> <i>Tabela 5: Institucionet dhe oraganizatat bashkepunuese ne rang programi per praktikat profesionale.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i dosjes ( <i>Evidenca: 53</i> ) të programit të studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, konstatohet se programi i studimit është organizuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë LAL 80/2015 dhe me aktet nënligjore në fuqi; organizuar në lëndë, të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe orenë auditor sipas formave të mësidhënies. Gjithsej ky program ka në total 60 kredite, me kohëzgjatje 1 vit akademik. Ngarkesa mësimore mesatare e studentit nuk tejkalon 25 orë në javë. Programi i studimit ofron një gamë të gjerë njohurish në kategorinë e lëndëve të formimit të përgjithshëm A (10 %) (6 kredite), lëndëve karakterizuese profesionale B (40%) (24 kredite), integruese të fushës C (30 %), (18 kredite) dhe lëndëve të aftësisimit informatik dhe praktikës profesionale D (10 %) (6 kredite) dhe temës së diplomës E (10 %)(6 kredite).  <i>Tabela 9:Plani mesimor i ndare sipas veprimtarive formuese.pdf</i>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një	Programet e lëndëve janë hartuar me qëllimin që studenti të fitojë njohuri të thelluara dhe me gamë të gjerë në fushën e marketingut dixhital. Ato janë të ndara sipas tipit të veprimtarisë A-E, duke



<p>llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>mundësuar kështu që përveç formimit në marketing dixhital të ketë mundësi që të krijojë një formim specifik në vartësi të dëshirave dhe rrethanave që i paraqitet secilit student. Programi i studimit synon të ofrojë me përfundimin e kursit, njohuri dhe kompetenca për studentët në fushat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në fushën e njohurive lidhur me studimin e tregut duke përdorur softe dhe teknika dixhitale,</li> <li>• Të jetë i aftë të hartojë strategji dhe politika në fushën e konkurrencës së teknologjive të informacionit,</li> <li>• Të jetë i aftë të ndërtojë një strategji të marketingut në fushën dixhitale,</li> <li>• Të jetë i aftë të menaxhojë nëpërmjet sistemit elektronik dhe instrumenteve informatike, klientët e kompanisë,</li> <li>• Të jetë i aftë të realizoj një komunikim dixhital nëpërmjet sistemeve të ndryshme të platformave,</li> <li>• Të ndërtojë faqe interneti që shërbejnë si platforma komunikimi dhe shitje,</li> <li>• Të dijë të analizoje dhe të menaxhojë sjelljen konsumatore duke përdorur metodat e kombinuara si të marketingut ashtu edhe të informatikës.</li> <li>• Etj</li> </ul> <p><i>Evidenca 53: Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise.pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Evidenca 57: Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhënies tabela 4.pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit te studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 59: Model i diplomes.pdf</i>  <i>Evidenca 60: Supplement i Diplomes.pdf</i>  <i>Evidenca 61: CV personeli akademik.pdf</i>  <i>Raport i Vleresimit te Brendshem.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Referuar RVB dhe planit mesimor, objektivat për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij janë të mirë përcaktuara.</p> <p>Sipas RVB, programi <i>synon pajisjen me njohuritë bashkëkohore të thelluara, aftësitë për të analizuar dhe përsosur sistemet e ndryshme të modeleve të konceptuara dhe ti përsosi ato në funksion të nevojave të kompanisë apo organizatës. Aisynon gjithashtu qëtu ofrojë studentëve njohuritë bazë praktike dhe të avancuara me qëllim që të mbulojnë detyra të rëndësishme në funksionin e marketingut.</i></p> <p>Nga analiza që GVJ i beri dosjes së programit të studimit, konstatohet se ky program i ofron studentëve njohuri të hollësishme teknike dhe</p>




	<p>nxit të menduarin kritik.</p> <p><i>Evidenca 53: Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mesimor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga analiza që GVJ i bëri dosjes së programit në të gjithë elementet e tij, në takime të realizuara me stafin akademik dhe studentët e këtij programi, GVJ vlerëson se lëndët e ofruara në këtë program, përmbajtja e syllabuseve të tyre, mundësojnë dhe aftësojnë studentin për të punuar në sektorin e marketingut e specifikisht në atë të marketingut dixhital.</p> <p><i>Evidenca 53: Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise.pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Evidenca 57: Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhenies tabela 4.pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit te studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 59: Model i diplomes.pdf</i>  <i>Evidenca 60: Supplement i Diplomes.pdf</i>  <i>Evidenca 61: CV personeli akademik.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas RVB, programi ofrohet me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Studimet përfundojnë me punimin e diplomës dhe në përfundim të tyre do të lëshohet diploma Master Profesional në “Marketing Dixhital”. Programi i studimit, përsa i përket këtyre elementeve, është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit mbi arsimin e lartë Nr. 80/2015 (neni 75) dhe aktet nënligjore përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar RVB, ky program është i organizuar në përputhje me VKM Nr. 41.2018, i ndryshuar, lëndët e parashikuara në planin mesimor janë të organizuar sipas kategorive (A-E) me ngarkesën në kredite përkatësisht A-6 ECTS, B-24 ECTS, C-18 ECTS, D-6 ECTS, E-6 ECTS. Të shpërndara në % si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndë bazë 10%</li> <li>• Lëndë karakterizuese 40 %</li> <li>• Lëndë ndërdisiplinore 30 %</li> <li>• Lëndë plotësuese, praktikë mësimore 10 %</li> <li>• Detyrime përmblyëse 10 %</li> </ul> <p><i>Tabela 9: Plani mesimor i ndare sipas veprimtarive formuese.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se programi i studimit MP në “Marketing Dixhital” parashikon gjithashtu edhe zhvillimin e praktikës profesionale, prej 150 orë (në auditor dhe jashtë auditorit) me 6 ECTS (1 kredit = 25 ore). Nga këto 120 orë pune parashikohen në një organizatë apo kompani dhe 30 ore pune të jenë individuale të studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar, studim literature, analizim idesh dhe praktikash etj.)</p>

	<p><i>Evidenca 53: Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise.pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Evidenca 57: Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhenies tabela 4.pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit te studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 59: Model i diplomes.pdf</i>  <i>Evidenca 60: Suplement i Diplomes.pdf</i>  <i>Evidenca 61: CV personeli akademik.pdf</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Administrimit është njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë që ofron programin e studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”. Nga dosja e vetëvlerësimit e paraqitur, rezulton se Fakulteti i Ekonomisë, UMT, përbëhet nga 3 departamente të cilët përmbushin kriteret ligjore për njësitë bazë. Universiteti Metropolitan Tirana, është i institucion i akredituar me Vendim Nr. 117, datë 15.12.2017 të Bordit të Akreditimit.</p> <p><i>Evidenca 13: Vendimi për akreditimin institucional të UMT nga Bordi i Akreditimit dhe certifikata e akreditimit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Administrimit, FE, përbëhet nga 29 staf akademik nga të cilët 9 janë të brendshëm dhe 19 të jashtëm dhe 1 staf ndihmës-akademik. 26 anëtarë të stafit akademik kanë grada e tituj, duke plotësuar në mënyrë optimale kriteret ligjore dhe standardet për të ofruar programin e studimit.</p> <p>Pjesë e stafit të ftuar janë personalitete të fushës së financave kryesisht me titull akademik, të cilët sjellin eksperiencën dhe informacionin që kanë në fushat e tyre specifike.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij 70 personel akademik gjithsej nga të cilët 24 me kohe të plotë, 45 me kohe të pjesshme dhe 1 ndihmes akademik, nga të cilët 57 me tituj e grada.</p> <p><i>Tabela 1: Numri i personelit Akademik per cdo njesi baze.pdf</i>  <i>Tabela 2: Personeli Akademik sipas njesive.pdf</i>  <i>Raport i Vleresimit te Brendshem</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Administrimit, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, ka në përbërje të tij 28 personel akademik nga të cilët 5 janë profesorë, 5 prof. As, 16 Dr. dhe 2 Msc. Nga 28 staf akademik, 9 janë personel akademik me kohë të plotë (1 prof, 1 prof as, 6 dr dhe 1 msc). Ngarkesa mësimore realizohet duke respektuar raportet midis personelit akademik me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar. Megjithatë me konsolidimin e këtij programi, rekomandojmë që institucioni në një plan afatmesëm të mundësojë rekrutimin e stafit të brendshëm me profil marketing.</p> <p><i>Tabela 1: Numri i personelit Akademik për çdo njësi baze.pdf</i>  <i>Tabela 2: Personeli Akademik sipas njësive.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Referuar evidencës të personelit akademik të Departamentit të Shkencave të Administrimit (<i>Tabela 2</i>) departamenti ka 9 pedagoge me kohë të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015. Rreth 71 % e ngarkesës mësimore të programit të studimit realizohet nga stafi me kohë të plotë në përputhje të plotë me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit akademik me kohë të plotë të UMT dhe pjesa tjetër nga stafi me kohë të pjesshme.</p> <p><i>Tabela 4: Ngarkesa totale e personelit akademik të programit në 1 vit akademik.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga UMT, nga vizita në institucion (me staf dhe studentët), praktikant profesional mbikëqyrën nga pedagog i departamentit, i cili bën mbikëqyrjen e studentit gjatë zhvillimit të praktikës nga ana formale dhe procedurale. Për disa lëndë që përmban ky program studimi, krahas stafit akademik me kohë të plotë bashkëpunohet edhe me stafin akademik ndihmës në disa lëndë që kanë të bëjnë me aplikimin e softeve të ndryshme në marketingun dixhital (<i>Tabela 2</i>).</p> <p>Praktika profesionale është përcaktuar në planin mësimor 120 orë (3 javë), e cila nga takimet me studentet rezultoi se kryhej realisht pranë institucioneve/kompanive përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Rregullorja e UMT-se, rregullorja e FE dhe rregullorja e programit të studimit, ngarkon përgjegjësin e departamentit me funksionet e hartimit të programeve të studimit dhe të mbikëqyrjes së ecurisë së tyre.</p> <p>Në nivel institucional është përcaktuar roli i koordinatorit të programit (përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj.) Koordinatori i programit raporton periodikisht nëmbledhjet e departamentit, raporton në lidhje me ecurinë e programit, aspektet pozitive, problemet dhe masat</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

20




lidhet me programin e studimit.	marra përzgjidhjene tyre.  <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit te studimit.pdf</i> <i>Evidenca 116: Shembull Minuta mbledhje Departamenti FE.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ, bazuar në takimet e kryera me stafin akademik gjatë vizitës në vend, konstatoi se informacioni për elementët e rëndësishëm të programeve të studimit janë publike dhe për informacione më të detajuara iu mundësohet akses lirisht si në format elektronik ashtu dhe ne hard copy, pranë departamentit. Tërësia e të dhënave na u demonstrua që gjendej në faqen zyrtare të universitetit, si dhe në platformën dixhitale që disponon UMT.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Referuar shqyrtimit të dosjes së programit ( <i>Evidencat 53-61</i> ), GVJ konstaton se programi i studimit MP në “Marketing Dixhital”, organizohet në lëndë, me kreditet përkatëse dhe ngarkesën në orë në auditor të shpërndarë sipas formave të mësimdhënies, sipas kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në IAL” dhe akteve nënligjore përkatëse (VKM Nr. 41 datë 24/01/208 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimin të Lartë”)
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Plani mësimor i programit të studimit është organizuar në lëndë të cilat vlerësohen në përputhje me sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), ku çdo lëndë ka 6 kredite. Mësimi organizohet në dy semestra dhe zhvillohet me zgjatje orare 50 minutash sipas përcaktimeve ligjore. Totali orëve që bën studenti në auditor dhe si punë e pavarur, konvertohet në kredite sipas raportit 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit.  <i>Tabela 10: Plani mesimor.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën	Nga shqyrtimi i dosjës së programit të studimit, pasqyrohet informacioni në lidhje me shpërndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor, orët jashtë auditorit, detyrimin për frekuentimindhe mënyrën

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

21

<p>mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>e vlerësimit për secilin element sipas sistemit të vlerësimit të integruar. Plani mësimor është i hartuar me përbërësit specifikë, me lëndë bazë të detyrueshme , lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.</p> <p><i>Tabela 10:Plani mesimor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Referuar rregullores së programit dhe rregullores së UMT, GVJ konstaton se në këto dokumente janë përcaktuar qartë kriteret që aplikohen për pranimin e studentëve, si dhe për procesin e transferimit të studentëve nga IAL të tjera drejt UMT-se dhe anasjelltas për programin e studimit MP ne “Marketing Dixhital”.</p> <p>Sipas RVB, <i>çdo vit akademik, me propozim të fakultetit, Senati Akademik i UMT –se, miraton kriteret specifike të pranimit në programin e studimit për vitin pasardhës. Këto kritere bëhen publike për tu njohur nga individët që zotërojnë të paktën diplomëbachelor sipas përcaktimeve në rregulloren e programit.Procesi i pranimit dhe regjistrimit administrohet nga sekretaria mësimore dhe nga komisionet ad hoc të ngritura nga Dekanati i FEUMT për përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me kuotat dhe kriteret e miratuara</i></p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit te studimit.pdf, neni 23, 24 dhe 25.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, përkatësisht syllabuset e lëndëve (Evidenca56), GVJ konstatoi se në përgjithësi në syllabusin e cdo lënde paraqitet informacion i detajuar. Format i syllabusit është i përcaktuar sipas një formati të gjithëpranuar. Konstatohen disa lapsuse ne informacionin te syllabuset të cilat ishin duke u konsideruar për vitin e ardhshem akademik. Një problematikë që ngriti institucioni ishte ndryshimet e vazhdueshme të akteve nënligjore që lidhen me hapjen e programeve të studimit apo dhe të elemnteve të studimit të dala nga institucionet shtetërore përgjegjëse.</p> <p>Referuar RVB, <i>programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulin, kursin dhe semestrin kur zhvillohet, karakterin e modulit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, kohëzgjatjen e modulit, kreditet, objektivat e modulit, elementët e mësimdhënies, detyrimet e studentit,metodat e vlerësimit dhe literaturës.</i></p> <p><i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Ky program është i ri, është viti i parë i ofrimit të tij në këtë institucion, por nga takimet me drejtuesit e fakultetit, te stafit akademik dhe NJSBC, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi angazhim dhe gadishmëri për rishikimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së programit (kjo mbështetur dhe në aktet rregullative të UMT të përmendura më sipër), si dhe shume të hapur ndaj sugjerimeve të GVJ për të përditësuar apo shtuar elementë që rrisin cilësisht aspektin formues të programit të studimit.</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesamësimore në programin e studimit është shpërndarë në përputhje me VKMnr.41,Dt. 24.01.2018, i ndryshuar, duke ruajtur ngarkesën ditore dhe ate javorenëauditor,përleksione,seminare,ushtrime, laboratorë, detyre kursi etj. Programi i studimit shtrihet në një vit akademik i ndarë në dy semestra, ne total 60 ECTS. Ora mësimore zgjat 50 minuta.  <i>Evidenca 89: Orari Mësimor.pdf</i> <i>Tabela 10:Plani mesimor.pdf</i> <i>Raporti i Vleresimit te Brendshem</i>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dosjes së programit, konstatojmë se emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, janë ndërtuar të tilla që ofrojnënjohuri në fushën e marketingut, si dhe lëndë aplikative nga fusha e teknologjisë së informacionit, duke ju mundësuar studentëve përvetësimin e kompetencave, aftësive dhe zotësive praktike me synim rritjen e mundësive të punësimit apo të vetëpunësimit të tyre.  <i>Evidenca 53: Te dhena te pergjitheshme per programin e studimit.pdf</i> <i>Evidenca 55: Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise.pdf</i> <i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i> <i>Evidenca 57: Ngarkesa ne auditore sipas formes se mesimdhënies tabela 4.pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit te studimit.pdf</i> <i>Evidenca 59: Model i diplomes.pdf</i> <i>Evidenca 60: Suplement i Diplomes.pdf</i> <i>Evidenca 61: CV personeli akademik.pdf</i> <i>Tabela 10:Plani mesimor.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.	Nga shqyrtimi i planit mësimor, GVJ konstaton se në semestrin e parë zhvillohen 5 lëndë, ndërsa në semestrin e dytë 3 lëndë, praktika profesionale dhe tema e diplomës. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në dy semestrat (përkatesisht 300 ore dhe 324 orë) është e balancuar dhe lë hapësira për kombinimin e formimit teorik dhe praktik.  <i>Tabela 10:Plani mesimor.pdf</i> <i>Tabela 14: Model i syllabusit.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit,	Nga shqyrtimi i dosjes së programit të studimit ( <i>Evidencat 53-61</i> ),

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

23

<p>lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>konstatojmë se programi i studimit MP në “Marketing Dixhital”, si program i ciklit të dytë, është i konsultuar me kurrikula të universiteteve të huaja, pasi në nivel kombëtar nuk ofrohet një i tillë në këtë cikël; është i organizuar sipas ligjit 80/2015, VKM Nr.41. dt. 24.01.2014. Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në orë/kredite) është përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore dhe përmban 1500 orë mësimore.</p> <p><i>Tabela 10: Plani mesimor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Ofrimi i aftësive të duhura, përfundimi i kompetencave sikurse edhe produkti i ofrimit të thelluar profesionalpërbejnë një sfidë për çdo program studimi, por veçanërisht në këtë program përpjekjet janë të dukshme. Kjo reflektohet në optimizimin dhe përkushtimin e të gjithë grupit drejtues të universitetit dhe fakultetit, të stafit të brendshëm dhe atij të jashtëm, sikurse edhe të studentëve.</p> <p>Bazuar mbi dokumentacionin shoqëruar të vënë në dispozicion si dhe në takimet e zhvilluara në vend, GVJ dha disa sugjerime në lidhje me brendësinë e syllabuseve, përditësimin e tyre, rifreskimin e literatures së përdorur. Këto përmirësime do të përfundojnë shumë më tepër kurikulën me nevojat e tregut, do të rrisin aftësitë e studentëve, përmirësojnë dukshëm kompetencat e tyre, si dhe rrisin aftësitë praktike të mjaft lëndëve.</p> <p>Bazuar në takimet me studentët, stafin dhe grupin e vlerësimit të brendshëm, rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ka patur një rast mobiliteti të një studenti i cili ka kryer semestrin e dytë në kuadër të projektit Erasmus dhe 2 lëndë i janë njohur nga departamenti. Studenti gjatë qëndrimit në vendin pritës ka studiuar 5 lëndë, nga të cilat 3 i ka marrë jashtë programit, për informacion dhe dije shtese. Por ajo ç’ka duhet cilësuar është se mobiliteti nuk ka patur problem të konvertimit të njohurive me programin aktual të studimit të tij në UMT;</li> <li>• Nga ana tjetër, dijet dhe njohuritë e perftuara kanë ndihmuar studentët jo vetëm në punësimin e tyre por edhe në ndërtimin dhe krijimin e start up-ëve. Kështu psh, dy studentë aktuale të këtij programi studimi janë mbështetur edhe nga stafi i brendshëm i këtij programi në hapjen e një start up-i.</li> </ul> <p><i>Evidenca 42: Plan për rishikimin e programeve mësimore.pdf</i>  <i>Evidenca 53: Te dhena të përgjithshme për programin e studimit.pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mesimor sipas llojit të veprimtarisë.pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lëndëve.pdf</i>  <i>Evidenca 61: CV personeli akademik.pdf</i>  <i>Evidenca 90: Shembull dosje transferimi studimesh.pdf</i>  <i>Evidenca 102: FE Raporti për metodat inovative në procesin e mësidhënies.pdf</i>  <i>Evidenca 124: Dokumentacion i praktikës për programin e studimit.pdf</i>  <i>Takimi me stafin, zv dekanin, dhe GVB</i></p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përpjekja për të mundësuar një studim tregu, i konsideruar si hap i parë dhe inovativ, sikurse edhe komoditeti i të qenurit lider në këtë program studimi, mundëson lehtësisht çdo përmirësim të mundshëm të kurrikulës në të ardhmen për të siguruar një produkt cilësor dhe po aq inovativ të UMT. Kështu, në përputhje me dy kriteret, 8 dhe 9 të këtij standardi, bazuar si mbi dokumentacion ashtu edhe mbi vizitën në institucion, veçanërisht diskutimet me stafin edhe grupin e vlerësimit të brendshëm rezulton se përpjekja e tyre është për t'u vlerësuar në përmbushje të përputhjes së këtij programi me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të patur formimin e duhur potencial.</p> <p>Programi i studimit MP në“Marketing Dixhital” siguron kompetenca dhe formim të thelluar profesional të studentit në fushën e marketingut dixhital. Por ne elementë të veçanta, programi ka nevojë të pasurohet në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve, me tematika të cilat konsiderohen relevante.</p> <p><i>Evidenca 55: Plani mesimor sipas llojit te veprimtarise.pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Evidenca 61: CV personeli akademik.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar të dhënave në dosjen e vetëvlerësimit të programi të studimit, GVJ konstaton se për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie 17 personel akademik (10 PAE në nivel fakulteti dhe 7 PAK) nga të cilët 14 prej tyre janë me tituj/grada (5 prof, 5 prof.as dhe 4 dr). Rreth 71 % e ngarkesës mësimore të programit të studimit mbulohet nga stafi i brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të personelit akademik (në dosjen e vetëvlerësimit dhe në takimin në zyrën e burimeve njerëzore) apo dhe nga njohjet personale në rrjetet akademike e profesionale, GVJ konstaton se ka një shpërndarje të ekuilibruar sipas titujve akademike apo gradave shkencoretë stafit akademik që mbulon programin.</p> <p><i>Tabela 4: Ngarkesa totale e personelit akademik te programit ne 1 vit akademik.pdf</i>  <i>Tabela 7, Te dhëna përmbledhëse te stafit akademik per programin e studimit sipas kualifikimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e</p>	<p>Anëtarët e personelit akademik që angazhohen në mësimdhënie, referuar tabelave te stafit, cv akademike të tyre dhe syllabuseve te lendeve qe ata</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

25




<p>përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>mbulojnë, GVJ konstaton se janë në përputhje me fushën e programit të studimit natyrë dhe specifikat e lëndëve.</p> <p>Edhe anëtarët e personelit ndihmës akademik dhe personeli me kohë të pjesshme që angazhohen në veprimtaritë mësimore, kanë të gjitha kualifikimet dhe kompetencën për të zhvilluar me cilësi programin e lëndës.</p> <p><i>Evidenca 56: Plan programet e lendeve.pdf</i>  <i>Evidenca 61: CV personeli akademik.pdf</i>  <i>Tabela 14: Model i syllabusit.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet me titullaret e fakultetit, me personelin akademik, studentët dhe zyrën përgjegjëse për komunikimin dhe marrëdhëniet, doli qartë se Universiteti Metropolitan Tirana, ka në prioritetin e tij sigurimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit brenda institucionit dhe me institucione të tjera, kompani apo organizata të ndryshme që kryejnë si aktivitet, marketingun, komunikimin dixhital etj.</p> <p>Gjithshtu, nga takimi me zv/dekanin e FEUMT, rezultoi se personeli akademik përgjegjës për realizimin e praktikës profesionale perzgjidhet në bazë të eksperiencës së tij në fushën e shkencave kompjuterike dhe të marketingut.</p> <p>Sipa RVB, praktikat profesionale zhvillohen në institucionet me të cilat ka marrëveshje të formalizuara ndër-institucionale, por edhe sipas marrëveshjeve afat shkurtër që diktohen nga nevojat dhe rrethanat e kryerjes së praktikës. Në bashkëpunim me institucionet ku do kryhet praktika, caktohet dhe personeli i duhur e i kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale në institucionin pritës.</p> <p><i>Evidenca 23: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf</i>  <i>Evidenca 53: Te dhena të përgjithshme për programin e studimit.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB si dhe vizitës së ambjenteve të zhvilluar në institucion, GVJ konstatoi se UMT garanton dhe siguron infrastrukturë laboratorike dhe profesionale, institucioni angazhon personel ndihmës mësimor e specialistë të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe praktikave profesionale edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit që ofrohet. Kjo dhe për faktin e bashkëpunimit të ngushtë me Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, njësi kryesore e UMT.</p> <p><i>Evidenca 67: FE Lista e plotë e personelit akademik dhe administrativ.pdf</i>  <i>Evidenca 79: UMT Guida e studentit.pdf</i>  <i>Tabela 1: Numri i personelit Akademik për çdo njësi baze.pdf</i>  <i>Tabela 16: Mjediset e Fakultetit, njësive baze.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluar në institucion (me titullaret e fakultetit, zyrën e këshillimit të karrieres dhe Alumni), GVJ konstatoi se në nivel institucional nëpërmjet bashkëpunimeve me partnerë dhe bashkëpunorë, UMT-ja vazhdimisht konsultohet lidhur me përshtatjen e programeve me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Referuar planit të zhvillimit strategjik të UMT-së (<i>Evidenca 3</i>), GVJ konstatoi se ne përmbushet te objektivat strategjike (<i>reference RVB</i>):</p> <p>1) Rritjen e numrit të projekteve të përbashkëta me impakt rajonal.</p> <p>2) rritjen e numrit të veprimtarive të përbashkëta, në organizimeme ALUMNI (<i>Evidenca 82</i>), që synojnë një ndikim në përmirësimin e cilësisë së specialistëve që përgatit UMT-ja dhe Departamenti i menaxhimit.</p> <p>UMT-jaka zhvilluar projekte rajonale me vendet e Ballkanit (<i>Evidenca 22</i>) me synim aplikimin e teknologjisë së informacionit në promovimin dhe menaxhimin e sektorëve të ndryshme të ekonomisë . Nga takimet, GVJ u njoh dhe me projektin e hartimit të një shkollë doktrate e përbashkët me disa vende të rajonit në këtë fushë.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumantacionit dhe takimit me studentet, GVJ konstatoi se përfshirja dhe perfaqesimi i studenteve dhe perfaqesive te tyre ne Senatin Akademik, NJSBC etj, jane te parashikuar ne aktet fundamentale te institucionit (<i>Evidenca 1</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Nga ana tjetër, gjatë takimit me përgjegjësin e departamentit, zv dekanin e fakultetit dhe me studentet, u konfirmua që zhvillohen mbledhje të hapura me studentët e programeve që mbulon departamenti përkatës, me qëllim që studentët të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimin të programit apo dhe problematika të tjera të hasuar nga ata.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Marketing Dixhital” është ende në vitin e parë dhe nuk ka student të diplomuar.</p> <p>Siç është referuar dhe në RVB dhe në takimet me zyrën e këshillimit të karrierës, çdo vit në javën e tretë të muajit Maj organizohet takimi me studentët ALUMNI, ku diskutohen tema të ndryshme që kanë të bëjnë me nevojën e përshtatjes dhe të rinovimit të programeve dhe nevojën që ato të përhapin idetë dhe praktikat e reja që marrin nga UMT-ja. (<i>Evidenca 82</i>). Gjithashtu, GVJ kuptoi se aktivitetet e organizuara me Alumni, përcaktojnë karakterit të marketingut, sillnin dhe gjallërimin/pasurimin e jetes se fakultetit/universitetit.</p> <p>GVJ, bazuar ne dokumentacionin e dosjes se vetevleresimit dhe takimeve me titullaret e fakultetit, konstatoi se eshte ne fokus te institucionit bashkëpunimi me organizatat/kompanitë publike dhe private, institucione kërkimore e shkencore, duke i parë sipas integrave e aktivitetit të Fakultetit të Ekonomisë, me synimin që nga keto bashkëpunime të merren kërkesa specifike lidhur me profesione të kërkuara nga tregu dhe njëkohësisht edhe vetë programet e studimit të</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	

	përshtaten në mënyrë të tillë që ti përgjigjen në mënyrë më eficente plotësimi të nevojave të formimit.  <i>Evidenca 22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimi në rrjete totale.pdf</i> <i>Evidenca 23: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dorëzuar në sistemin e menaxhimit të ASCAL si dhe nga takimet e realizuara në UMT, rezultojnë se ky institucioni përkrah aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit. Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies tregon përpjekjet e institucionit për përdorimin e metodave inovative, gjë që përmirëson më shumë procesin e mësimnxënies dhe i bën studentët më pjesëmarrës dhe krijues në procesin mësimor.  <i>Evidenca 102: Raport për metodat inovative të mësimdhënies. pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ konstatoi se drejtuesit e njësive kryesore, përgjegjësit e departamenteve si njësi bazë së bashku me NJSBC, funksionimi i së cilës përcaktohet nga rregullorja e UMT-së si dhe struktura të tjera <i>ad-hoc</i> , zhvillojnë mekanizma monitorimi të vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies në të gjithë elementët e saj si leksione, seminare, punëve laboratorike dhe praktikën profesionale. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në: <ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerësimin e mësimdhënies në auditor, për personelin akademik (lektor dhe asistentë lektor) nga përgjegjësi i departamentit dhe Dekani.</li> <li>Në hartimin e planit vjetor të punës, ku janë të përfshirë të gjithë elementët e procesit mësimor, kërkimor dhe administrativ, në fillim të vitit akademik nga përgjegjësi i departamentit së</li> </ul>

	<p>bashku me pedagogun përkatës. Mbi bazën e këtij plani bëhet vlerësimi i personelit në fund të vitit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në raportimin e rezultateve të vlerësimit semestral nga NJSBC, tek Dekani dhe Senati akademik brenda 15 ditëve nga përfundimi i semestrit.</li> <li>• Vlerësimin nëpërmjet sondazhit, ku tërhiqet mendimi dhe opinion i studentëve për performancën akademike të stafit mësimdhënës.</li> </ul> <p><i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>  <i>Evidenca 39: UMT plan pune. pdf</i>  <i>Evidenca 40: FE plan pune. pdf</i>  <i>Evidenca 102 Raport vlerësimi i NJSBC-së. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezulton se studentët para përfundimit të çdo semestri përfshihen në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Përveç kontrollit periodik të realizuar nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me NJSBC-në, për mënyrën e zhvillimit të leksioneve duke asistuar në leksion dhe më pas duke diskutuar konkluzionet me pedagogun dhe studentët e grupit, NJSBC-ja organizon një anketim çdo semester dhe për çdo lëndë për të vlerësuar performancën e lektorëve në mësimdhënie.</p> <p>Sipas rregullores së UMT-se, NJSBC-ja harton formularin e anketimit, i cili më pas miratohet nga rektorati. Rezultatet e përpunuara i dërgohen pedagogëve brenda 15 ditëve, ndërsa NJSBC-ja brenda 10 ditëve harton raportin e vlerësimit përfundimtarë të cilësisë dhe ja paraqet drejtuesve të njesive kryesore dhe Rektorit.</p> <p>Gjithashtu institucioni garanton ankimimin e studentëve për rezultatet e vlerësimit, sipas një procedure të përcaktuar, ku verifikimi i vlerësimit bëhet me komision dhe miratohet nga dekanat.</p> <p><i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>  <i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 127: Shembull ankime note. Pdf</i>  <i>Evidenca 135: proces verbalet e kontrollit dhe përpunim. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC-ja, si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në UMT, pasi realizon sondazhet e studentëve, rezultatet e përpunara nga zyra e IT-së i dërgohen përgjegjësit të departamentit, dekanit, u bëhen publike pedagogëve dhe pasi diskutohen në Rektorat, studentëve ju komunikohen problemet e evidentuara dhe masat që do të marrë Rektorati dhe dekanati në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>  <i>Evidenca 73: Raport vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar –UMT. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik</p>	<p>Nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion rezultoi se Departamenti i Shkencave Administrative dhe Fakulteti i Ekonomisë bazuar në të dhënat e përfunduara nga vlerësimet periodike kanë marrë masa për nxitjen, rritjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kështu janë organizuar seminare të ndryshme për</p>




për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	mënyrën e zhvillimit të leksioneve, përmirësimin e infrastrukturës, madje ka edhe lëvizje të pedagogeve.			
	<i>Evidenca 85: Format pyetësi student -NJSBC. pdf</i> <i>Evidenca 115: Pocesverbal i kontrollit ne auditore. pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Referuar rregullores së UMT-së, si dhe takimeve me stafin dhe studentët, u konstatua se në këtë cikël studimesh përdoren forma alternative si leksione, seminarë, punë laboratorike, detyra kurse, projekte kurse, provime të ndërmjetme dhe përfunimtare, praktika mësimore dhe profesionale.</p> <p>GVJ konstatoi, se ka përputhshmëri mes specifikimeve të rregullores dhe përcaktimeve të këtyre formave në syllabus dhe në aplikim.</p> <p>Programi i studimit MP në “Marketing Dixhital” ofrohet i vlerësuar me kredite në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS) ku, orët/kreditet e këtij cikli studimesh janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 60 Kredite në 1 vit akademik;</li> <li>• Orë totale 1500, ku, 624 orë në auditor, (nga të cilat 240 orë leksione 165 orë seminarë, 55 orë ushtrime/labotatorë, 20 orë forma kontrolli në auditor, 120 orë praktika profesionale dhe 24 orë provim i përgjithshëm/ diplomë) dhe 876 orë jashtë auditorit;</li> <li>• Praktika profesionale 6 kredite</li> <li>• Provim i përgjithshëm/Diploma 6 kredite</li> </ul> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i> <i>Evidenca 56: Plan programet e lëndëve/syllabuset. pdf</i> <i>Tabela 10: Plani Mësimor. pdf</i> <i>Tabela 13: Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program. pdf</i> <i>Tabela 14: Modeli i syllabuseve. Pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese	<p>Bazuar në RVB dhe nga informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, rezultoi se, stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijes. Nga bashkëbisedimi me studentët u konstatua se përveç leksioneve, gjatë seminarëve krahas kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve dhe diskutimeve, aplikohen edhe raste studimore e detyrat individuale me studentët. Natyra specifike e këtij program studimi kërkon përdorimin dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

30

<p>në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>aplikimin e metodave të larmishme të mësimdhënies nëpërmjet kompjuterave dhe sistemit të rrjeteve të internetit.</p> <p><i>Tabela 10: Plani Mësimor. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se Fakulteti i Ekonomisë në UMT, me synimin e përmirësimit të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies, ka investuar në teknologji si dhe ka zhvilluar leksione të hapura, seminare dhe ëorkshope si në kuadër universiteti ashtu edhe në kuadër të sektorit të turizmit.</p> <p>Gjithashtu, UMT ka marrëveshje me universitete të tjera partnere perëndimore dhe rajonale, ku stafi akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit.</p> <p><i>Evidenca 23: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE. pdf</i> <i>Evidenca 93: Raporti mbi aktivitetin Kërkimor-Shkencor të stafit akademik – FE. Pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion si dhe referuar CV-ve, fushave të ekspertizës dhe eksperiencës së stafit, rezultoi se stafi akademik është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe transmetimin e njohurive, nëpërmjet përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit përkatës.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përbëhet nga :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 10 pedagogë efektiv, prej të cilëve 6 janë të kategorisë profesorë (4 Prof dhe 2 Prof As); 1 me gradën Dr dhe 3 Msc.</li> <li>• 7 pedagogë me kontratë, prej të cilëve 4 janë të kategorisë profesorë (1 Prof dhe 3 prof.As) dhe 3 doktor.</li> </ul> <p>Personeli akademik përdor me kompetencë pajisjet në dispozicion të mësimdhënies si dhe ka pajisur studentët me tekste dhe cikël leksionesh.</p> <p><i>Evidenca 61: CV_Personeli Akademik_FE. pdf</i> <i>Tabela 4: Ngarkesa totale e personelit akademik të programit në një vit akademik. pdf</i> <i>Tabela 6: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit. pdf</i> <i>Tabela 7: Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni periodikisht vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e këtyre metodave në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët. Studentet i shprehin shqetësimet dhe sugjerimet e tyre nëpërmjet këshilltarit akademik ose pranë zyrës së shërbimit ndaj studentëve, të cilat i përcillen drejtuesve të njësisë bazë dhe asaj kryesore, apo edhe me lart sipas problematikes së paraqitur.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies përdoren edhe rezultatet e marra nga pyetësorët e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 123: Axhenda e Këshilltarëve Akademik. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe</p>	<p>Sipas RVB-së, për ti bërë orët e mësimi sa më konkrete dhe tërheqëse, stafi akademik i brendshëm dhe i jashtëm i Departamentit të Shkencave</p>

diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Administrative, i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përdor metoda interaktive dhe diskutimi me studentët duke i dhënë më shumë mundësi pjesëmarrjes në diskutime. Diskutimet e rasteve studimore, puna ne grupe dhe prezantimet e punëve studimore të studentëve, janë disa prej mjeteve kryesore të nxitjes së debateve dhe mendimit kritik që garantojnë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga informacioni i siguruar në takimin me studentët e Masterit Professional në “Marketing Dixhital”, gjatë vizitës në institucion, u konstatua se metodat e mësimdhënies të përdorura nga pedagogët inkurajojnë autonomi tek studentët dhe sigurojnë marrëdhënie respekti të ndërsjellë. Studentët inkurajohen të ndërmarrin iniciativa në përzgjedhjen e detyrave të kursit të cilat zhvillohen në grup, gjë që jep mundësi çdo studenti të shprehë idetë e veta dhe të rrisë shkallën e bashkëpunimit në grup. Bashkëpunimi midis studentëve dhe pedagogëve realizohet si gjatë orëve të procesit mësimor ashtu edhe në orët e konsultimeve, të cilat janë të programuara në ditë dhe orë të përcaktuara për çdo program studimi.  <i>Evidenca 123: Oraret e Konsultimeve për programetstudimit në FE. pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b> <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se procesi mësimor dhe shkencor në UMT realizohet në hapësira të mjaftueshme të pajisura me mjete dhe pajisje didaktike. GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se sallat e leksioneve/seminareve dhe laboratorëve, janë të mjaftueshme dhe procesi mësimor edhe për MP në “Marketing Dixhital”, zhvillohet në dy godina në Rrugën “BUDI”, pranë Qytetit Studenti, Tiranë. Godina 1, përmban 13 auditore për leksione dhe seminare, me një kapacitet akomodimi prej 500 studentë dhe dy laboratore, ndërsa Godina 2, ka 12 auditorë po me kapacitet prej 500 studentesh dhe 4 laboratorë. Auditorët janë të pastra dhe me të gjitha kushtet për një zhvillim normal të procesit mësimor. Godinat janë të pajisura me zyra, mjedise shërbimi, mjedise për aktivitete të ndryshme, hapsira rekreative si dhe nyje hidrosanitare. Të gjitha mjediset janë të pajisura me sistem ngrohjeje.  <i>Evidenca 107: Abjentet për Infrastrukturën te UMT-FE. pdf</i> <i>Evidenca 108: Asete infrastrukurore akademike_UMT. pdf</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

32



	<i>Tabela 16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë. pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të Masterit Profesional “Marketing Dixhital”, të vendosura në Godinën Nr.1, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të nevojshme, të mjaftueshme për të zhvilluar në mënyrë efektive procesin mësimor.</p> <p>Të gjithë auditorët janë të pajisur me poste ulje, tavolina, lidhje interneti, kompjutera, videoprojektor etj. Në të gjitha mjediset e punës funksionon sistemi i ngrohje-ftohjes dhe ajri i kondicionuar.</p> <p>Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor, gjithashtu plotësojnë të gjitha kriteret teknike si dhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, 8.6 m<sup>2</sup> për student nga 2.5 m<sup>2</sup> që është normativa dhe 8.3 m<sup>2</sup> për punonjës nga 4 m<sup>2</sup> që është normativa.</p> <p><i>Evidenca 107: Abjentet për Infrastrukturën te UMT-FE. Pdf</i> <i>Tabela 16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë. pdf</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	<p>Referuar RVB-së, dhe informacionit të siguruar në institucion, personeli akademik dhe studentët e të gjitha cikleve, përfshirë edhe studentët e këtij programi studimi kanë në dispozicion të procesit mësimor dy salla kompjuterash dhe sallën e internetit. Sistemi i IT-së në UMT, është i personalizuar për të kryer funksione të ndryshme të menaxhimit të procesit mësimor, të menaxhimit të sekretarisë dhe elementë të tjerë të menaxhimit.</p> <p>Gjithashtu, UMT ka një sistem informatike në aspektin e kërkimit dhe të zhvillimit të procesit mësimor, ku çdo auditor është i pajisur me kompjutera, me internet dhe me video projektor, etj.</p> <p>Që nga viti 2012 në UMT është implemetuar sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve, i cili është përsosur në vitin e fundit 2019 -2020.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>GVJ, nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se për çdo lëndë të Masterit Profesional “Marketing Dixhital” literatura bazë ofrohet në gjuhën Shqipe dhe përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt etj. Një pjesë të literaturës studentë e gjejnë fizikisht në bibliotekën e fakultetit, në gjuhën Shqipe dhe në gjuhën Angleze apo në gjuhë të tjera të komunitetit europian.</p> <p><i>Evidenca 109: Relacion biblioteke (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore Informatike UMT-FE. pdf</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	<p>Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion, GVJ është e mendimit se biblioteka e institucionit disponon mjaftueshëm literature në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe pasurohet vazhdimisht duke reflektuar ndryshimet e programit të studimit.</p> <p>Mjediset e bibliotekave kanë hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët dhe pedagogët dhe janë në dispozicion të tyre nga ora 10.00 deri në orën 20.00.</p> <p>Në bashkëpunim me sektorin e IT është realizuar dixhitalizimi i materialeve dhe botimeve të ndryshme, si dhe është bërë e mundur marrja e informacionit nga studentët nëpërmjet rrjetave on-line.</p> <p><i>Evidenca 109: Relacion biblioteke (hard copy dhe elektronike) dhe</i></p>

	<i>laboratore Informatike_UMT-FE. pdf.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë libraritë on-line nga mjediset e bibliotekës, e cila është e pajisur me PC. Studentët dhe stafi i UMT-se ka akses në: LMS <a href="http://students.edu.al">http://students.edu.al</a> <a href="http://www.thefreelibrary.com/http://www.gutenberg.org">http://www.thefreelibrary.com/http://www.gutenberg.org</a> <a href="http://www.gutenberg.org/ëëë.laëlink.coe.int;">http://www.gutenberg.org/ëëë.laëlink.coe.int;</a> <a href="http://www.lawlink.nse.gov.au;">www.lawlink.nse.gov.au;</a> <a href="http://www.localjuris.com.fr;">www.localjuris.com.fr;</a> <a href="http://www.acesmylibrary.com/article-161-16233801;">www.acesmylibrary.com/article-161-16233801;</a> <a href="https://doaj.org/">https://doaj.org/</a>
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga informacioni i siguruar nga vizita në institucion si dhe nga RVB-ja, studentët e programit Master Profesional ne “Marketing Dixhital”si dhe stafi akademik, kanë mundësinë që të aksesojnë dokumentacionin elektronik, të downlojojnë leksionet etj. Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme referuar programit mësimor të MP ne “Marketing Dixhital”.  <i>Evidenca 56: Plan programet e lëndëve/syllabuset. Pdf</i> <i>Evidenca 107: Abjentet për Infrastrukturën te UMT-FE. pdf</i> <i>Tabela 10: Plani Mësimor. pdf</i>
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Sipas RVB-së në UMT,në ndihmë të procesit mësimor, duke gërshetuar formimin në auditor dhe jashtë tij, për këtë program studimi që po akreditohet, por edhe për të tjerë përdoret platforma <i>edu4school</i> . Me anë të kësaj platforme mundësohet hedhja e materialeve didaktike dhe komunikimi me studentët për problemet e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Per mësimin online eshte përdorur platforma <i>gotomeeting</i> dhe <i>edu4school</i> . Stafi akademik përdor edhe platforma te personalizuara. Institucioni synon të krijojë platforma alternative për situata të ndryshme, në ndihmë të procesit të te mësuarit direkt, duke synuar pjesëmarrjen në projekte të ndryshme.  <i>Evidenca 47: Print Screen të faqes ëeb lidhur me veprimtarinë kërkimore shkencore. pdf</i>
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët e UMT-së, përdorin sistemin informatik që disponon UMT dhe kanë hapësirat e veta siç është emaili individual, emaili me domain-in e universitetit @umt.edu.al dhe sistemin <i>edu4school</i> , i instaluar në të gjitha njësitet e UMT-së.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me stafin akademik, studentët si dhe dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, personeli akademik i Departamentit të Shkencave Administrative, orienton studentët e Masterit Profesional ne “Marketing Dixhital”, në përzgjedhjen e temës së diplomës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti, të përcaktuara që në fillim të semestrit të parë të vitit

	<p>akademik.</p> <p>Procesi i zgjedhjes, realizmit dhe mbrojtjes së diplomës, është i rregulluar me rregulloren mbi përgatitjen e diplomave dhe të procesit mësimor, ku parashikohet që studenti ka të drejtë të zgjedhë temën e diplomës, e cila konsultohet më pas me drejtuesin e punimit.</p> <p>Pedagogu udhëheqës gjatë gjithë kohës asiston në zhvillimin e temës duke komunikuar në forma të ndryshme me studentin. Në fund pasi e rishikon punimin ai jep miratimin për mbrojtjen e temës së diplomës duke e nënshkruar atë.</p> <p><i>Evidenca 64: Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës. pdf</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>UMT ka ngritur struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura në funksion të procesit msimor-kërkimor, të përcaktuara me vendim të Dekanatit Nr 737/1date 22.10.2019 funksionojnë si një sistem që përbëhet nga: këshilltarët akademikë, NJSBC, departamenti dhe fakulteti. Këto njësi bëjnë përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p><i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC. pdf</i>  <i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 11: Model i pyetësorit për studentët. pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	<p>Nga kontaktet e realizuara, gjatë visitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë në ASCAL, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe ajo bazë nxit dhe mbështet proceset, të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit. Departamenti i Shkencave Administrative pranë Fakultetit të Ekonomisë në UMT, si njësi bazë inicion procese për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet tërheqjes së mendimit të studentëve dhe diskutimeve, pothuajse për të gjitha lendet dhe disa herë gjatë semestrit.</p> <p><i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë. Pdf</i>  <i>Evidenca 85: Format pyetësori studenti -NJSBC. pdf</i>  <i>Evidenca 113: Axhenda e takimeve të Këshilltarëve akademik-Semestri i parë. pdf</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin	Referuar RVB-së, rezulton se strukturat dhe njësitë përgjegjëse pranë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

35

<p>eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>UMT-së, i krijojnë mundësi dhe inkurajojnë personelin akademik të zhvillojë metoda të reja në mësimdhënie në përshtatje me zhvillimin e programit të studimit. Përveç përdorimit nga personeli akademik që zhvillon procesin e mësimdhënies në programin e studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital”, të mjeteve vizuale, përdoren edhe metoda të tilla, që fokusohen në organizimin e leksioneve me specialistët më të mirë të fushave përkatëse në Shqipëri, me pedagogë të fakulteteve të tjera të vendit, si dhe leksione me specialistë të huaj që kanë punuar në fushën e marketingut siç është rasti i dy profesorëve Grekë, nga të cilët njeri prej tyre ka qenë edhe punonjës i marketingut në kompaninë farmaceutike NORVATIS në Zvicër.</p> <p><i>Evidenca 72: Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve- UMT. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion konstatoi se UMT, ofron mundësi për kualifikim të vazhdueshëm të personelit, nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit. Kualifikimi jashtë vendit realizohet nëpërmjet studimeve afat shkurtër ose afat gjatë, si dhe nëpërmjet programeve të mobilitetit të pedagogëve. UMT ka marrëveshje bashkëpunimi me organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe ka realizuar disa projekte mobiliteti sic është projekti ERAZMUS. Stafi i Departamentit të Shkencave Administrative si pjesë e personelit të UMT-së, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital”, është i angazhuar në kërkimin shkencor i financuar nga UMT-ja si dhe nga projekte ndërkombëtare si p.sh. projekti “SMART Marketing”,projekti <i>Montenegro–Albania reform on doctorate studies</i> etj.Gjithashtu, në kete kuadër fakulteti dhe departamenti organizon aktivitete kërkimore shkencore si seminare, konferenca me pjesëmarrjen dhe angazhimin e personelit akademik.</p> <p><i>Evidenca 22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete. pdf</i>  <i>Evidenca 23: Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FE. pdf</i>  <i>Evidenca 24: Lista e projekteve të aplikuar nga UMT dhe projektet fituese. pdf</i>  <i>Evidenca 100: Lista e Konferencave shkencore. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Referuar RVB-së, takimit me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe me stafin akademik, u konstatua se UMT trajnon vazhdimisht personelin akademik, për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Kështu, stafi akademik trajnohet edhe nëpërmjet aktiviteteve, leksioneve të hapura, konsultimeve, ëorkshopeve etj, si dhe referimeve të lektorëve vendas dhe të huaj. Sipas statutit dhe rregullores së UMT-sësi dhe ne planin strategjik të institucionit personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion konstatoi se personeli akademik dhe ndihmës akademik në UMT, është i angazhuar në realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të programit të studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital” si dhe për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Institucioni synon që të ndjekë projektin Modle, që është një platformë që u jep mundesi pedagogëve</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

36




<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>dhe studentëve për një mësim të personalizuar.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT. pdf</i>  <i>Evidenca 99: Lista aktiviteteve, leksioneve të hapura_FE. pdf</i>  <i>Evidenca 102: Raporti për metodat inovative në procesin e mësimdhënies. pdf</i>            (Link<a href="http://modle.org/">http://modle.org/</a>).</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion konstatoi se UMT, angazhon në procesin mësimor specialistët më ekperiencë të vendit, por edhe profesorë dhe specialistë të huaj, të cilët me eksperiencën e tyre kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies si dhe në rritjen e kualifikimit të pedagogëve mësimdhënës në programin e studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”.</p> <p><i>Evidenca 36: Publikimi në ëeb të UMT_së të gjithë njoftimeve. pdf</i>            (linku përkatëse)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ, nga dokumentacioni i depozituar nga institucioni konstatoi se, mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në rregullore të posaçme siç janë rregullorja e UMT-së, rregullorja e fakultetit, rregullorja e programit të studimit si dhe rregullorja e provimeve.</p> <p>Në këto rregullore parashikohen të gjithaelemntet e procesit të vlerësimit si detyra shtëpie, detyra kursi, punë në grup, provimi i parë dhe provimi i dytë. Rregulloret janë të publikuara në web-sitin e UMT-së. Njohja e studentëve me këto rregullore shihet si një e drejtë dhe detyrim i tyre dhe janë pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i>  <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë. pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit Master Profesional “Marketingu Dixhital”. pdf</i>  <i>Evidenca 120: Rregullore e provimeve UMT. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të</p>	<p>Ngatakimi me studentët dhe stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se studentët informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për, programin e lëndës, format alternative të vlerësimit dhe detyrimet që ata kanë, informacione që studentët mund ti gjejnë edhe në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

37




parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	syllabuset e lëndëve. <i>Evidenca 56: Plan programet e lëndëve/syllabuset. pdf</i> <i>Evidenca 63: Procedura për zhvillimin e provimeve_FE. pdf</i> <i>Tabela 14: Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018. pdf</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit dhe masa e vlerësimit të çdo komponenti. Këto forma janë alternative dhe të ndryshme duke iu dhënë mundësi studentëve, të demonstrojnë njohuritë e përfituara.  <i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i> <i>Tabela 14: Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018. pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	GVJ, referuar syllabuseve dhe takimit me stafin akademik dhe studentët, konkludon se vlerësimi është semestral, me komponente të tillë si: detyrat e kursit, esete, cilat zhvillohen gjatë semestrit dhe vlerësohen në masën 10%, provimi i ndërmjetëm 20%, detyra kursi 10% dhe provimi final 60%. Të gjithë komponentët reflektohen në vlerësimin final.  <i>Evidenca 56: Plan programet e lëndëve/syllabuset. pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit Master Profesional “Marketingu Dixhital”. pdf</i> <i>Tabela 15: Format e kontrollit të njohurive. pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Referuar RVB-së, konstatohet se UMT, për të siguruar transparencën, objektivitetin vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmin në vlerësime, ka bërë marrëveshje me Albanian American Development Foundation, për shtrirjen e projektit <i>Clean Score</i> , pjesë e të cilit është edhe korrigjimi i provimeve.  <i>Evidenca 49: Udhëzim mbi mësidhënien në distancë. pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit Master Profesional “Marketingu Dixhital”. pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Nga komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë, rezulton se testimi përfundimtar, sipas rregullores së UMT-së, dhe rregullores së provimeve realizohet nga një komision, i cili ka jo më pak se 2 anëtarë të departamentit dhe miratohet nga dekani i fakultetit.  <i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i> <i>Evidenca 63: Procedura për zhvillimin e provimeve_FE. pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim,	GVJ, konstaton se provimet realizohen të sekretuara, për të ruajtur

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

38

<p>zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>anonimitetin e studentëve. Tezat përgatiten nga titullari i lendes dhe asistenti ose njëanëtarjetër i komisionit dhe sekretohen nga sekretaria me bar kod dhe më pas kontrollohen nga pedagogu në mënyrë anonime. Për të siguruar kontrollin e provimeve në mënyrë sa më objektive, UMT ka siguruar përdorimin e projektit <i>Clean Score</i>, që i kontrollon në mënyrë automatike dhe me objektivitet.</p> <p><i>Evidenca 95: Rregullore e Sekretarisë UMT-së. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar RVB-së, rezulton se stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital”, këshillon dhe orienton studentët në lidhje me të gjithë elementet e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me qëllim për të ndihmuar studentët të përmirësohen në mësimnxënie. Gjithashtu, sipas rregulloreve në fuqi lektorët ballafaqojnë vlerësimet e provimeve me studentët, ku, ata kanë mundësi të marrin feedback dhe të konsultojnë vlerësimin e tezave të tyre.</p> <p><i>Evidenca 46: Modele Procesverbale provime, listë notash studenti, vërtetime studenti. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga komisioni për të shmangur kopjimin. Në UMT departamentet dhe personeli akademik respektojnë rregulloren e provimit dhe të etikës në lidhje me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit.</p> <p><i>Evidenca 14: Rregullore e Etikës –UMT. pdf</i> <i>Evidenca 63: Procedura për zhvillimin e provimeve_FE. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët e Masterit Profesional ne “Marketing Dixhital”, vlerësimet i marrin në kohën e përcaktuar sipas rregulloreve përkatëse. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë semestrit, vlerësime këto që janë komponentë të vlerësimit final.</p> <p>Teza ndërtohet bazuar në nivele të ndryshme njohurish, duke filluar nga të thjeshtat deri tek më të vështirat. Teza korrigjohet dhe brenda tre ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet ne departament.</p> <p><i>Evidenca 63: Procedura për zhvillimin e provimeve_FE. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të depozituar në sistemin AMS por edhe takimeve me studentët e programit, studenti ka të sanksionuar të drejtën për tu njohur me vlerësimin, me mënyrën e korrigjimit, për të qenë i qartë për gabimet në përgjigje dhe për vlerësimin sipas meritës. Stafi akademik mësimdhënës në kete program studiimi, pas korrigjimit të tezës, hedh në sistem pikët e të gjithë komponentëve të vlerësimit dhe automatikisht del nota përfundimtare. Ngadata e daljes së rezultatit përfundimtar studentët brenda 48 orëve kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të rezultatit. Pedagogu bën rishikimin sipas rregullores së provimeve dhe vendosnotën përfundimtare.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga institucioni si rregullorja e UMT-së, rregullorja e provimeve etj. GVJ, konstaton se studenti e ka të sanksionuar të drejtën e ankimit për rezultatet. Procedura e ndjekur për ankimim, për zgjidhjen e ankesës si dhe</p>

	vendimi i marrë realizohet në afate të përcaktuara.			
	<i>Evidenca 63: Procedura për zhvillimin e provimeve_FE.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Referuar RVB-së dhe informacionit të siguruar nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se programi i studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital”, i cili përmban 10 lëndë, garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në funksion të aplikimit të metodave teorike dhe praktike në lidhje me marketingun dixhital dhe është në përputhje me KornizënShqiptare të Kualifikimit niveli Nr 7.</p> <p>Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit duke vënë theksin më shumë nëinstrumente praktike në lidhje me mënyrën e organizimit të marketingut në rrugë elektronike,gjë që sjell njëç’vendosje të marketingut nga forma tradicionale në forma virtuale.</p> <p>Në programine studimit MP ne “Marketing Dixhital” theks të veçantë i vihet praktikës profesionale, e cila zhvillohet në subjektet, aktiviteti i të cilave përputhet me natyrën e programit të studimit si dhe punimittë diplomës që i jep mundësi studentit të thellojënjohuritë dhe aftësitë profesionale.</p> <p><i>Evidenca 54: Plani mësimo.pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor.pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Referuar planit mësimor, program i studimit të ciklit të dytë Master Profesional ne “Marketing Dixhital” është hartuar në mënyrë të tillë, që studentët të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve, të marrin njohuri teorike dhe praktike në funksion të aplikimeve të ndryshme në fushën e marketingut dixhital, ku ndërthuret shkenca e IT-së me marketingun,siç është marketingu dixhital. Lëndë të tilla si E-marketingu, ECRM, Planifikim dhe strategji e marketingut dixhital, etj, ndihmojnë studentët për tu aftësuar në fushën e marketingut dixhital duke aplikuar informatikën në marketing dhe konceptet e marketingut në informatikë.</p> <p><i>Evidenca 54: Plani mësimor.pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor.pdf</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit	<p>Nga RVB-ja dhe takimi me studentët e programit, rezultoi se në fillim të semestrit, studentët marrin informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Në syllabuset e</p>



<p>dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>lëndëve studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në lëndën përkatëse. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës.</p> <p>Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët, në seancën e fundit të semestrit çdo pedagog në fund të semestrit mbas përfundimit të lëndës, realizon një përmbledhje të temave kryesore dhe analizon çështjet e ndryshme që janë konstatuar gjatë trajtimit si të panevojshme apo të pa plotësuara.</p> <p>Gjithashtu, në grupet mësimore diskutohen çështje për përmirësimin në vazhdimësi të syllabusit si dhe çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin në vazhdimësi të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe në mënyrë të strukturuar i paraqiten departamentit për diskutim.</p> <p><i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC për pyetëtorët e stafit akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 11: Model i pyetësorit për studentët. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Referuar dokumentacionit, GVJ, konstaton se në përfundim të leksioneve çdo pedagog organizon një séancë përmblylëse e të gjitha temave, ku studentët sqarohen për paqartësitë dhe orientohen për përgatitjen e provimit përfundimtar. Pedagogu në përfundim vë në dispozicion të studentëve literaturën e nevojshme të përmbledhur dhe orienton studentët tek ato pjesë më të rëndësishme që duhen përgatitur për provim. Të gjithë pedagogët e lëndëve shpallin oraret e konsultimeve.</p> <p><i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC për pyetëtorët e stafit akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 11: Model i pyetësorit për studentët. pdf</i>  <i>Evidenca 97: Oraret e Konsultimeve për programet studimit në FE. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezulton se personeli akademik i programit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, zhvillon aktivitete të ndryshme të tilla si, orë të hapura dhe seminare mbi çështje që lidhen me situatën dhe problemet aktuale të zhvillimit të marketingut dixhital dhe ku, informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës. Seminarat zhvillohen në mënyrë interaktive, me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime, proces përmes të cilit ata arrijnë të qartësojnë dhe krijojnë ide, të bëjnë aplikime të ndryshme, të formulojnë dhe realizojnë ide, projekte dhe qëllime të caktuara.</p> <p><i>Evidenca 117: Faqja ëeb dhe Rrjetet Sociale _UMT. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Referuar planit mësimor, syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezulton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruar nga teoria. Ka lëndë në program, që zhvillohen tërësisht në kushtet laboratorike nëpërmjet kompjuterëve mbi bazën e aplikacioneve të ndryshme si dhe nëpërmjet sistemit të internetit.</p>




	<p><i>Evidenca 55: Plani mësimor. pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lëndëve/syllabuset. pdf</i>  <i>Tabela 10: Plani mësimor. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Studentët inkurajohen të punojnë në mënyrë individuale ose në grupe për të realizuar një projekt, detyrë kursi apo stimulim i zgjidhjes së një problemi biznesi në fushën e marketingut. Nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës, organizohen seminare, motivohen dhe inkurajon studentët për të dhënë mendime për çështje të caktuara, duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi në tregun imagjinar.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Stafi akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të marketingut dhe identifikon momentet që kanë nevojë për më shumë informacion dhe studim të mëtejshëm. Këto probleme bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema diplome. Pedagogët komunikojnë mjaft mirë me studentët duke bërë që procesi mësimor të zhvillohet në mënyrë të natyrshme dhe pa sforcime. I gjithë ky proces monitorohet dhe një nga mënyrat është edhe pyetësori që bëhet në fund të lëndës me studentët.</p> <p>Vënia në dispozicion e gjithë materialit didaktik në mënyrë paraprake nëpërmjet platformës elektronike dhe kërkesa për zgjidhjen e situatave reale në procesin mësimor i nxit studentët të hulumtojnë, shpjegojnë situatave reale dhe të shprehin idetë e tyre.</p> <p><i>Evidenca 3: Plani strategjik i zhvillimit të UMT. pdf</i>  <i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 11: Model i pyetësorit për studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, nga takimi me studentë dhe stafin akademik si dhe bazuar në rregulloret e ndryshme të institucioni, rezulton se studentët kanë të drejtë për aplikim pranë institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe pranë universitetit për financimin e veprimtarive kërkimore shkencore nën logon e UMT-së.</p> <p>UMT-ja nëpërmjet inkubatorit të biznesit, mbështet studentët në idetë krijuese në fusha të ndryshme të biznesit, teknologjisë së informacionit, teknologjisë së ndërtimit dhe në fusha të tjera. Studentët inkurajohen të marrin pjesë tek inkubatori i fakultetit me ide novative për aktivitete “start up”. Gjithashtu UMT-ja vë në dispozicion të kërkuesve salla të ndryshme për të realizuar punët kërkimore, laboratorë informatike për të demonstruar mënyrën e zbatimit të marketingut dixhital si dhe bibliotekën me librat në disa kopje dhe në rrugë elektronike.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin</p>	<p>GVJ, konstaton përpjekje të institucionit për të rritur mobilitetin e studentëve, për të ndërthurur format e mësimdhënies. UMT-ja ka bashkëpunim me një numër të konsiderueshëm universitetesh brenda</p>




e studentëve.	dhe jashtë vendit. Edhe pse është viti i parë i veprimtarisë së këtij programi studimi, një student i këtij programi studimi ka kryer mobilitet me Erasmus+ në Universitetin e Konstancës, Rumani për 6 muaj.			
	<p><i>Evidenca 23: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE. pdf</i>  <i>Evidenca 25: Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik në kuadër të erasmus+. pdf</i>  <i>Evidenca 26: Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për studentët në kuadër të erasmus +. pdf</i>  <i>Evidenca 27: Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit/mobilitetit. pdf</i>  <i>Evidenca 28: Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT. pdf</i>  <i>Evidenca 117: Faqja ëeb dhe Rrjetet Sociale _UMT. pdf</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<p>Nga RVB-ja, vizita në institucion si dhe nga takimi me studentët e programit të studimit Master Profesional në “MarketingDixhital”, rezultoi se praktikat profesionale zhvillohen kryesisht në mjedise jashtë fakultetit kryesisht pranë bizneseve me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, lista e të cilëve i vihet në dispozicion studentëve për të përzgjedhur, ose në biznese që studentët i kanë siguruar vetë individualisht. Përsa i përket praktikave laboratorike në lëndë të caktuara, ato zhvillohen në mjediset e institucionit, në laboratore, që disponojnë infrastrukturën dhe kapacitetin e duhur të posteve për të zhvilluar procese normale.</p> <p><i>Evidenca 22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe anëtarësimet në rrjete. pdf</i>  <i>Evidenca 23: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE. pdf</i>  <i>Tabela 16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë. pdf</i>  <i>Tabela 17: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj. pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	<p>GVJ konstatoi se insitucioni për realizimin e praktikave profesionale në ne kete program studimi, ka vendosur lidhje bashkëpunimi me një sërë institucionesh dhe subjektsh private që plotësojnë kushtet e duhura, për të qënë vend zhvillimi i praktikave.</p> <p><i>Evidenca 22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete</i>  <i>Evidenca 23: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE. pdf</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Praktikë profesionale,	Referuar planit mësimor të Masterit Profesional në “Marketing

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

43

<p>klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Dixhital”, praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë dhe ka 6 kredite. Në përfundim të praktikës profesionale studenti bën mbrojtjen e saj para komisionit duke prezantuar dhe mbrojtur raportin e praktikës në data dhe orare të përcaktuara. Vlerësimi i praktikës bëhet me notë në procesvrbal si të gjitha lëndët e tjera.</p> <p><i>Evidenca 54: Plani mësimor. pdf</i>  <i>Evidenca124: Ddokumentacioni i praktikës për programin e studimit. pdf</i>  <i>Tabela 16: Plani mësimor. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.9</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Referuar rregullores së institucionit, të njësisë kryesore, rregullores së programit të studimit si dhe procedurës së diplomimit, cikli i dytë i studimeve Master Profesional përmbyllet me punim diplome.</p> <p>Departamenti i Shkencave Administrative pranë Fakultetit të Ekonomisë si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, harton paraprakisht një paketë udhëzuese lidhur me procedurat dhe afatet kohore, udhëzimet mbi strukturën si dhe rregullat ndryshme për procesin e mbrojtjes së diplomës dhe i njej studentët me këto procedura dhe udhëzime, për t’ju ardhur në ndihmë atyre, që të përfundojnë me sukses të gjitha hapat deri në mbrojtje të diplomës për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit Master Profesional “Marketingu Dixhital”. pdf</i>  <i>Evidenca 64: Procedura e mbrojtjes së diplomës. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga RVB-ja, shqyrtimi i dokumentacionit në sistem si dhe nga takimi me studentët rezultoi se strukturat përgjegjëse të programit të studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital” dhe personeli akademik i Departamentit të Shkencave Administrative pranë Fakultetit të Ekonomisë në UMT, asistojnë studentët duke vënë në dispozicion të tyre të gjitha informacionet e nevojshme në funksion të përgatitjes dhe mbrojtjes së mikrotezës, institucioni për përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës ka vënë në dispozicion një laborator informatike i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme që të bëjë të mundur përpunimin praktik të ideve teorike të shtruar nga studentët për zgjidhje praktike.</p> <p><i>Evidenca 64: Procedura e mbrojtjes së diplomës. pdf</i>  <i>Evidenca 65: Plan pune për mbrojtjen e diplomës. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për</p>	<p>Referuar rregullores së institucionit, të njësisë kryesore, si dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

44

<p>administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>rregullores së programit të studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital”, cikli i dytë i studimeve Master Profesional përmbillet vetëm me mbrojtjen e diplomës. Mbrojtja e diplomës bëhet para një komisioni të përbërë nga pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm, i propozuar nga njësia bazë dhe i miratuar nga dekani, ku kryetari i komisionit caktohet po nga dekani. Komisioni funksionon kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve dhe mbrojtja bëhet publike. Vlerësimi i punimit bëhet bazuar në: origjinalitetin, saktësinëshkencore, saktësinë e të shkruarit, mënyrën e prezantimit etj.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i> <i>Evidenca 64: Procedura e mbrojtjes së diplomës. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Referuar rregullores së mbrojtjes së diplomave, puna fillon me përcaktimin e listës së kandidatëve udhëheqës,ku studentët mund të kontaktojnë me ç’do njerin prej emrave të listuar me qëllim që të marrin orientime duhur për përcaktimin e fushës së kërkimit në kuadrin e përgatitjes së mikrotezës në mbrojtje të diplomës.</p> <p><i>Evidenca 64: Procedura e mbrojtjes së diplomës. pdf</i> <i>Evidenca 65: Plan pune për mbrojtjen e diplomës. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ është e mendimit se institucioni ka kapacitetet e duhura për ti asistuar studentët në përgatitjen e punimit të temës sipas fushës së studimit. Për të realizuar kërkimin e tyre shkencor studentët e Masterit Profesional ne “Marketing Dixhital”, kanë në dispozicion të tyre të gjitha burimet didaktike, informatike, salla, laboratore kompjuterash, biblioteka dhe specialistë të IT-së.</p> <p><i>Evidenca 64: Procedura e mbrojtjes së diplomës. pdf</i> <i>Evidenca 65: Plan pune për mbrojtjen e diplomës. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar RVB-së, GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës pas përcaktimit të programit të punës së studentit, për realizimin e diplomës si dhe afatet e përfundimit të saj, është në kontakt të vazhdueshëm me studentin për përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve. Në fund udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit, garanton origjinalitetin e punimit dhe cilësinë e rezultateve si dhe lejon mbrojtjen e tij, duke e nënshkruar. Mendimi i udhëheqësit shprehet nëpërmjet vlerësimit duke plotësuar një formular i cili përmban elementët e vlerësimit dhe vlerësimin total.</p> <p><i>Evidenca 64: Procedura e mbrojtjes së diplomës. pdf</i> <i>Evidenca 65: Plan pune për mbrojtjen e diplomës. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Referuar rregullores së diplomimit, komisioni bazuar në prezantimin e punimit nga studentit e vlerëson atë me pike, të cilat më tej konvertohen në notë në përfundim të vlerësimit të punimit të diplomës, sipas rregullave të UMT-së për kontrollin e dijeve.</p> <p><i>Evidenca 64: Procedura e mbrojtjes së diplomës. pdf</i> <i>Evidenca 65: Plan pune për mbrojtjen e diplomës. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me</p>	<p>Siç është e parashikuar në rregulloren e institucionit, bazuar të ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e</p>

diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Shqipërisë”,nenit 91,në përfundim të studimeve në Programin Master Profesional, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës.  <i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i> <i>Evidenca 59: Modeli i diplomës. pdf</i> <i>Evidenca 60: Suplementi i diplomës. pdf</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti merr diplomën se bashku me suplementin. Institucioni, me kërkesë të studentit, i ve në dispozicion një kopje te plote zyrtare te programit të studimit.  <i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i> <i>Evidenca 59: Modeli i diplomës. pdf</i> <i>Evidenca 60: Suplementi i diplomës. pdf</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Bazuarnë parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personalei gjithë dokumentacioni për studentët përpunohet dhe ruhet nga institucioni. Ky dokumentacion ruhet në sekretari deri në momentin që studenti merr diplomën.  <i>Evidenca 45: Ndërfaqja (Administratori, Pedagogu, Sekretaria, Studenti. pdf</i> <i>Evidenca 114: Rregullore e arkivës UMT. pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri I</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të	Referuar dokumentacionit të depozituar në sistemin AMS në ASCAL si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se UMT, disponon të dhënat për çdo vit akademik, të stafit akademik që përfshihet në program. Këto të dhëna, përmbajnë emrat e stafit akademik, lëndët për çdo semestër, orët mësimore dhe ngarkesën totale si dhe statusin e tij, si PAE apo PAK. Personi përgjegjës për organizimin e programit të studimit Master Profesional ne “MarketingDixhital”, është përgjegjësi i departamentit të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

46

<p>studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Shkencave Administrative, i cili ka gradën shkencore “Doktor”. Nga konsultimi i dosjeve të stafit të programit, rezultoi se në dosjet e perzgjedhura në mënyrë rastësore gjendet dokumentacioni si, kontrat e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV etj.</p> <p><i>Evidenca 66: Lista e plotë e personelit akademik me kohë të plotë, me kohë të pjesshme_FE_Tab.Nr.2. pdf</i>  <i>Evidenca 68: Të dhëna statistikore të personelit akademik PAE_PAK_Tab.Nr. 1. pdf</i>  <i>Evidenca 69: Të dhëna për mbulimin e lëndëve me personel akademik. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë perzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të depozituar në sistemin AMS në ASCAL si dhe takimit me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njërëzore në UMT, rezulton se procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në përputhje me Statutin e UMT-së, neni 60 dhe rregulloren e UMT-së, nenet 11 dhe 12. Kanje koordinim mes njësisë bazë përgjegjëse për këtë program si dhe zyrës së Burimeve Njërëzore në nivel institucioni, me përgjegjësi të ndara dhe në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore. Referuar informacionit të konsultuar në sistemin AMS të ASCAL, rezulton se institucioni, ka një tërësi rregulloresh dhe procedurash të mbështetur në bazë ligjore në lidhje me rekrutimin e stafit akademik.</p> <p>Kriteret e punësimit të personelit akademik përcaktohen nga njësia bazë, në bazë të nevojave dhe miratohen nga rektori. Përzgjedhja e kandidatit bëhet nga një komision <i>ad-hoc</i>, ngritur nga rektori. Kohëzgjatja e kontratës së punës si dhe kushtet e tjera, përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës dhe arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p><i>Evidenca 1: Statutii UMT-së. pdf</i>  <i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të</p>	<p>Referuar dokumentacionit në sistemin AMS te ASCAL, vizitës në institucion si dhe takimeve me grupe të ndryshme, konstatohet se</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

47




<p>barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit të përshtashëm për personelin. Institucioni ka siguruar investime, të cilat ofrojnë mjedise të mirëpajisura për çdo anëtar të stafit akademik dhe administrativ, që u krijojnë mundësi për realizimin e detyrave të tyre profesionale.</p> <p><i>Evidenca 107: Abjentet për Infrastrukturën te UMT-FE. pdf</i>  <i>Evidenca 108: Asete infrastrukturore akademike _UMT. pdf</i>  <i>Tabela 16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>UMT mbështet stafin e tij për kualifikim të mëtejshëm. Institucioni promovon programe në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim, që kanë të bëjnë me sigurimin e të dhënave shkencore, përditësimin e materialit didaktik, pjesëmarrjen në konferenca e seminare kombëtare e rajonale, organizimin e konferencave etj.</p> <p>Stafi zhvillon takime të rregullta brenda departamentit si për vetëkualifikimin e tij, ashtu dhe për marrjen e vendimeve të rëndësishme që lidhen me mësimdhënien, studentët dhe probleme të tjera.</p> <p>Ne kuadër të programit “ERASMUS”, pedagogët e brendshëm marrin pjesë rregullisht në ëorkshope në vende të Bashkimit Europian.</p> <p>Gjithashtu për stafin e ri akademik janë organizuar dhe seminare me pedagogë huaj si në kuadrin e programeve ERASMUS, ashtu edhe me programe të tjera apo të financuara nga UMT-ja</p> <p>Është krijuar një traditë e mirë organizimi i lektoriumeve dhe me pedagogë vendas dhe të huaj lidhur me tema të ndryshme si në fushën e financës, të marketingut, të strategjisë së biznesit, të strategjisë së marketingut, të vlerësimit të pasurive të patundshme etj.</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020, është organizuar një konferencë me titull “Dixhitalizimi i Biznesit” si dhe java e inovacionit me pjesëmarrjen e lektorëve ndërkombëtare nga universitete Amerikane, nga Greqia, nga Shqipëria etj.</p> <p><i>Evidenca 93: Raporti mbi aktivitetin Kërkimor-Shkencor të stafit akademik - FE. pdf</i>  <i>Evidenca 93: Aplikimet për kërkim shkencor, email për thirrjet FE. pdf</i>  <i>Evidenca 99: Lista aktivitetëve, leksioneve të hapura FE. pdf</i>  <i>Evidenca 100: Lista e Konferencave shkencore. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga takimet me stafin akademik të programit të studimit Master Profesional në “MarketingDixhital”, rezulton se mbështetja e institucionit me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin me metodat inovative, ka përmirësuar ndjeshëm mësimdhënien, nëpërmjet eksperiencave në universitete të ndryshme europiane, por edhe brenda vendit. Zyra dhe sallat ku realizohet procesi mësimor janë të kompletuara me të gjitha mjetet e nevojshme, me kompjuter me programet përkatëse, me projektor, me tabela të cilësisë sa lartë, etj.</p> <p>Janë zhvilluar një numër seminaresh në lidhje me metodat e mësimdhënies me pedagogë të universiteteve të huaja dhe kryesisht me ato Greke dhe Polake, ku përfaqësues të tyre nëpërmjet programeve ERASMUS, kanë ardhur në UMT dhe kanë dhënë eksperiencën e tyre. Gjithashtu, personeli akademik i UMT-së ka shkuar në universitete</p>






	<p>të huaja gjë që u ka krijuar mundësinë që të marrin eksperiencën e nevojshme në shumë fusha, por edhe në atë të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Evidenca 28: Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të UMT. pdf</i>  <i>Evidenca 72: Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve- UMT. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UMT dëshmon për një angazhim të burimeve njerëzore, stafit akademik dhe atij administrativ, për përmbushjen e objektivave të programit të studimit Master Profesional ne “MarketingDixhital”. Planin mësimor, syllabuset, orari i mësimit si dhe dokumentet që stafi akademik depoziton në departament etj., flasin për një staf akademik të angazhuar për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi, gjë që u konstatua edhe në takimin me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ, konstaton gjithashtu, se edhe stafi administrativ dëshmon përkushtim në realizimin e detyrave të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 69: Të dhëna për mbulimin e lëndëve me personel akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 71: Model i formularit të vlerësimit të performancës. pdf</i>  <i>Evidenca 72: Lista e lektorëve të huaj dhe e aktiviteteve- UMT. pdf</i>  <i>Tabela 6: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.3</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB-së, vizitës në institucion dhe të dhënave në sistemin AMS për infrastrukturën e UMT-së (të marra nga evidencat e poshtëshënuara), GVJ konstatoi se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit të programit Master Profesionalne “MarketingDixhital”.</p> <p><i>Evidenca 107: Abjentet për Infrastrukturën te UMT-FE. pdf</i>  <i>Evidenca 108: Asete infrastrukturore akademike _UMT. pdf</i>  <i>Tabela 16: Mjediset e Fakultetit/Njësive Baz. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive</p>	<p>Godinat, ku zhvillon mësimin ky program studimi, janë të pajisur me mjedise bashkekohore si auditore, laboratore, boblioteka etj, mjaft të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me numrin e studentëve dhe veçortitë specifike të programit të studimit.</p> <p>Në laboratore, për secilin student janë vënë kompjutera, ku studentët përdorin programet e instaluara, internetin dhe platforma te ndryshme si dhemund të ndërtojnë vetë platforma në funksion të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

49

<p>bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>marketingut.Kompjuterët, projektorët, interneti, janë të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 48: Platforma për mësim online. pdf</i> <i>Tabela 17: Të dhëna mbi platformat dhe bibliotekat online. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të programit të studimit Master Profesional ne “MarketingDixhital” si klasa, labore e mjedise të tjera, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme si, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, ëhitebord, smartboard, videoprojektor etj., që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik, përmes përdorimit të teknologjisë bashkëkohore në misimdhënie.</p> <p><i>Tabela 17: Të dhëna mbi platformat dhe bibliotekat online. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Referuar planit mësimor të programit të studimit, rezulton se studenti kryen 150 orë praktikë mësimor/profesionale, nga të cilat 120 orë kryen pranë institucioneve dhe shoqërive private ose edhe shtetërore, të miratuara nga UMT dhe 30 orë janë punë e pavarur e studentit në auditorët e shkollës. Për praktikën profesionale, UMT ka marrëveshje bashkëpunimi me organizata dhe kompani, publike dhe private.</p> <p><i>Evidenca 55: Plani mësimor. pdf</i> <i>Tabela 5: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikant profesional me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Pdf</i> <i>Tabela 10: Plani mësimor. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit</p>	<p>Në dispozicion të studentëve të UMT-së ekziston biblioteka, me një sipërfaqe prej 110 m<sup>2</sup>, në mjediset e së cilës studentët e këtij programi studimi, kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. Biblioteka është</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

50




<p>në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>e kompletuar me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime dhe në fondin e saj numëron rreth 622 libra, që u përkasin rreth 333titujve të ndryshëm.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i>  <i>Evidenca 109: Relacion biblioteke dhe laboratore informatike UMT. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe relacionit në Evidencen nr. 109, të depozituar në sistemin e AMS, rezulton se fondi i bibliotekës në UMT, aktualisht numëron rreth 333 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe mbulon të gjitha fakultetet e institucionit. Literatura është kryesisht shkencore e me vjetërsi 5-10 vite.</p> <p>Studentët e MP ne“MarketingDixhital” kanë në dispozicion tekste mësimore të hartuara nga pedagogë me emër të universiteteve të tjera në vend, si dhe leksione të shkruara për lëndët e reja. UMT, ka siguruar një numër të tekstesh në mbështetje të programeve të studimit, nga libraria prestigjioze nderkombetare MacGraë Hill, por duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për shtimin e fondit të bibliotekës me tekste hard copy dhe elektronike që kanë të bëjnë me programin e studimit në fjalë.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e UMT-së. pdf</i>  <i>Evidenca 109: Relacion biblioteke dhe laboratore informatike UMT. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi prezencën e librave dhe literaturës ndihmëse fizike, por edhe faktin që studentët kanë akses në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë duke ofruar edhe platforma online. UMT ofron aplikacionin <i>edu4school</i>, i cili ofron leksione që janë në përputhje me syllabuset dhe tekste bashkëkohore. Bazuar në rregulloren e Bibliotekës, UMT-ja u garanton akses në data bazë online të gjithë studentëveku, bëjnë pjesë edhe studentët e programit të studimit MP ne“Marketing Dixhital”.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Referuar RVB-së, rezulton se biblioteka shkencore e UMT-së, është e pajisur me kompjutera në të cilat janë instaluar programe që ju krijojnë mundësinë studentëve për të gjetur literaturën që atyre junevojitet për të kryer detyrat e ndryshme, kërkime apo për të realizuar aktivitete kërkimore të niveleve më të larta.</p> <p><i>Evidenca 107: Abjentet për Infrastrukturën te UMT-FE. pdf</i>  <i>Evidenca 108: Asete infrastrukurore akademike _UMT. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Referuar RVB-së, rezulton se çdo vit kalendarik UMT, parashikon dhe shpenzon fonde të planifikuara për blerjen e literaturës shkencore të specializuar sipas programevetë studimit që ofron si dhe në fushën e kërkimit shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Referuar RVB-së dhe dokumentacionit të depozituar në sistemin AMS, GVJ konstaton se orari i Bibliotekës, është në përputhje me orarin e zhvillimit të programit të studimitMP ne“Marketing Dixhital”. Orari i Bibliotekës është çdo ditë nga ora 10.00 – 20.00. Biblioteka ka dy nënndarje kryesore, salla me fond të hapur ofron shërbime për studentët dhe pedagogët meliteraturë preferenciale, literature të printuar dhe nga burime elektronike të brendshme dhe të huaja, internet etj. Ndërsa fondi i mbyllur ofron kryesisht literaturë në gjuhë të huaj,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

51

	<p>revista,gazeta,fjalore, arkivën dixhitale etj. Koleksioni përpunohet nga ana bibliografike konform standardeve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (Internacional Standard Bibliographic Descripton) dhe formatin MARC, Z39.50SRU.</p> <p><i>Evidenca 47: Print Screen të faqes ëeb lidhur me veprimtarinë kërkimore shkencore. pdf</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Referuar RVB-së dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se të dhënat dhe informacionet në lidhje me studentët dhe veprimtarinë e tyre regjistrohen dhe arkivohen nga sekretaria mësimore.</p> <p>Sekretaria mësimore përpunon të gjithë dokumentacionin e studentit, duke krijuar për çdo student dosje personale elektronike dhe hard copy, që pasqyrojnë dokumentacionin e nevojshëm, të gjitha rezultatet e provimeve, të detyrave të kursit, të prezencës në mësim, të dhënat mbi bursat apo tarifat e studimit dhe masa disiplinore të marra në qoftë se ka deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit.</p> <p><i>Evidenca 44: Manuale përdorimi të Sistemit informatik te studenteve. pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore dhe nga RVB-ja, rezultoi se informacioni lidhur me personelin administrohet nga departamenti dhe zyra e burimeve njerëzore. Departamenti mban dosjen personale për çdo pedagog ku përfshihen informacione mbi ecurinë e punës kërkimore dhe shkencore të tij. Ndërsa zyra e burimeve njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin lidhur me punësimin, shkallën e kualifikimit, ecurinë në karrierë për personelin akademik, si dhe të dhënat lidhur me aktivitetin e personelit ndihmësakademik dhe administrativ.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi dy dosje pedagogësh të kategorisë PAE dhe PAK.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit krijon akses për personelin dhe studentët në formë të ndryshme si përmes raporteve të analizave vjetore mësimore dhe shkencore në nivel departamenti, përmes publikimit të informacioneve në ëeb dhe në stendat e institucionit.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka	Referuar RVB-së por edhe takimeve me studentët e programit si dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

52

<p>të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit MP ne “Marketing Dixhital”, rezulton se në institucion, për komunikimin interaktiv të stafit akademik me studentët përdoren emaili dhe sistemi <i>edu4school, gomeeting</i> si dhe platforma të tjera. Për ndjekjen e mungesave, realizimin e planeve mesimore, syllabusave, realizimin e orëve të mësimi etj, përdoret platforma <i>edu4school</i>.</p> <p><i>Evidenca 44: Manuale përdorimi të Sistemit informatik të studentëve. pdf)</i>  <i>Evidenca 47: Print Screen të faqes ëeb lidhur me veprimtarinë kërkimore shkencore. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe administrativ, në UMT, bëhet nëpërmjet platformës interaktive <i>edu4School</i>, që ka implementuar institucioni. Në këtë platformë është pasqyruar kalendari akademik, plani mësimor sipas programeve dhe semestrave, grupet mësimore, orari, dhe klasat. Ndërsa studenti këtu mund të ndjekë në kohë reale materialet didaktike, frekuentimin, rezultatet dhe pedagogët pasqyrojnë syllabusin e lëndës, materialet didaktike si dhe vleresimet e pjesëshme dhe përfundimare të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 44: Manuale përdorimi të Sistemit informatik të studentëve. Pdf</i>  <i>Evidenca 47: Print Screen të faqes ëeb lidhur me veprimtarinë kërkimore shkencore. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>GVJ konstaton se ëebi i institucionit është funksional, ai është dy gjuhësh, shqip dhe anglisht. Në ëeb GVJ, konstatoi të dhëna, rreth fakultetit, departamentit, programeve të studimit, syllabuseve etj. Gjithashtu UMT është aktiv edhe në rrjetet sociale.</p> <p><i>Evidenca 117: Faqja ëeb dhe Rrjetet Sociale_UMT. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një</p>	<p>GVJ, referuar RVB-së dhe dokumentacionit në sistem, konstaton se UMT harton një plan financiar kupërllogaritet kostoja e studimit për çdo student dhe mënyra e mbulimit të saj. Në rastin e UMT-së kostoja është më e madhe se të ardhurat nga studentët, prandaj dhe mbulohet nga aksioneret e universitetit.</p> <p>Plani financiar detajon kostot për të gjithë zërat në shërbim të realizimit të programit të studimit që nga shërbimet operative, kostot e burimeve njerëzore, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, për bibliotekën etj.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

53




<p>programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>UMT garanton vazhdimësinë e procesit mësimor me të gjitha standardet e parashikuara. Në kompletimin me pajisje kompjuterike dhe me programe e softëare kanë ndihmuar edhe financimet nga programet e ndryshme të fituara në Bashkimin Europian me partnerë të tjerë.</p> <p><i>Evidenca 118: Shpenzimet dhe të ardhurat në FE në 3 vitet e fundit_Tab.Nr.10. pdf</i>  <i>Evidenca 119: Vendim Senati për vlerësimin e vazhduar UMT. pdf</i>  <i>Evidenca 125: Donacionet nga projektet për laboratorët UMT. pdf</i>  <i>Tabela 18: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>GVJ referuar RVB-së, konstaton se çdo vit institucioni kryen auditim në përputhje me standardet e kontrollit dhe duke marrë në konsideratë plotësimin e nevojave të procesit mësimor shkencor. Raportin financiar si dhe raportin e auditit miratohen nga Bordi i Administrimit.</p> <p><i>Evidenca 129: Evidencë Auditimi Financiar UMT. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni harton raportin financiar për çdo vit akademik për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si dhe nivelin e shpenzimeve. Gjithashtu ky dokument shërben për të përcaktuar masën e realizimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve si dhe për të evidentuar dhe planifikuar nevojat për financim dhe si rrjedhojë edhe ndërhyrjet e nevojshme. Planifikimi i financimit hartohet në fillim të vitit dhe është i ndarë në financime nga kuotat e studentëve, nga projektet dhe nga subvencionet e aksionereve.</p> <p><i>Evidenca 129: Evidencë Auditimi Financiar UMT. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Referuar RVB-së konstatohet se UMT i ka mjetet e nevojshme financiare për realizimin me sukses të procesit mësimor, se edhe në të kaluarën nuk ka pasur probleme në drejtim të mos financimit. UMT ka siguruar qëndrueshmëri në financim dhe në të ardhmen një gjë e tillë është e garantuar nga të ardhurat e studentëve, por edhe financimi i aksionereve.</p> <p><i>Evidenca 118: Shpenzimet dhe të ardhurat në FE në 3 vitet e fundit_Tab.Nr.10. pdf</i>  <i>Evidenca 119: Vendim Senati për vlerësimin e vazhduar UMT. pdf</i>  <i>Tabela 18: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përcaktimin e kriterëve pranuese të MP ne “Marketing Dixhital”, institucioni ndjek të njëjtat politika dhe praktika si edhe për programet e tjera të studimit. Procedurat dhe kriteret e pranimit në MP janë në përputhje me politikat e institucionit. Kriteret dhe procedurat e pranimit janë në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në legjislacion dhe specifikohen gjithashtu në statutin dhe rregulloren e UMT-së, në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë si dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloret përkatëse dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR).</p> <p>Pranimi i kandidatëve në këtë program studimi bazohet në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim, ndërsa studentët fitues përzgjidhen bazuar në kriteret e përcaktuara me vendim të Senatit Akademik të UMT-së.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 33: Kriteret e pranimit në programet e ciklit të I dhe të integruar të ciklit të dytë miratuar me VSA, viti akademik 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021. pdf</i>  <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë. pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në rastin e programit të studimit MP ne “Marketing Dixhital”, në çdo vit akademik, hapja e tij propozohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe i dërgohet për miratim Senatit Akademik të UMT-së.</p> <p>Transparenca, aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me programin e studimit në UMT dhe në Fakultetin e Ekonomisë, për kandidatët dhe për të gjithë të interesuarit e tjerë për të vazhduar studimet në kete program studimi, bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit si dhe mjeteve të komunikimit. E gjitha kjo procedurë bazohet në statutin e UMT-së, në rregulloren e tij, ne</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

55

	rregulloren e programit te studimit etj.  <i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i> <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i> <i>Evidenca 33: Kriteret e pranimit në programet e ciklit të I dhe të integruar të ciklit të dytë miratuar me VSA, viti akademik 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021. pdf</i> <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë. pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Referuar RVB-së, GVJ konstaton se, institucioni bën publike kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për tu pranuar në ciklin e dytë të studimeve që janë përcaktuar në rregulloren e UMT-së, nenet 13 dhe 15. Këto kriteret bëhen publike nga UMT-ja si dhe nga Fakulteti i Ekonomisë drejtëpërsëdrejti ose nëpërmjet sektorit të marketingut, i cili përdor ëëbsaitin si dhe mjete të tjera komunikimi.  <i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i> <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Referuar RVB-së, GVJ konstaton se, kandidatët qe duan të ndjekin studimet në ciklin e dytë si dhe gjithë publiku informohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike që kërkohen për tu regjistruar në këtë master. Megjithatë GVJ sugjeron që, për të siguruar sukses afatgjatë, të programit të studimit, njësitë përgjegjëse për këtë program studimi duhet të intensifikojnë komunikimin e tyre.  <i>Evidenca 36: Publikimi në ëeb të UMT_së të gjithë njoftimeve (linku përkatës. pdf)</i> <i>Evidenca 88: Plani Marketingut-UMT. pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Njësia bazë dhe sekretaria mësimore, vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregullorja e UMT, rregullorja e FE, rregullorja e sekretarisë mësimore dhe rregullorja e programit të studimit. Gjithashtu, stafi i angazhuar në këtë program studimi dhe sekretaria mësimore, vënë në dispozicion të studentëve syllabuset si dhe kriteret

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

56



	<p>për kalimin nga një vit në tjetrin. Nga sa më sipër GVJ, konstaton që institucioni është i pajisur me strukturat përkatëse si dhe me procedurat e rregulluara dhe zbatuara nga strukturat përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i> <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë. pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i> <i>Evidenca95: Rregullore e Sekretarisë së UMT. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Informacioni është i detajuar në syllabusin e të gjitha moduleve të programit të studimit MP ne “MarketingDixhital”. Stafi gjithashtu informon studentët në javën e parë të fillimit të mësimit.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i> <i>Evidenca 56: Plan programet elëndëve/syllabuset. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nëlidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve,studenti informohet, nëpërmjet rregulloressëUMT-së dhe rregullores së programit të studimit, ku këto kritere janë të detajuara dhe ku përcaktohet pesha në kredite si dhe numri i krediteve, që studentit duhet të ketë para diplomimit. Referuar dokumentacionit në sistem, GVJvëren që për këtë program studimi ka indikatorët të matshëm për vlerësimin e cilësisë së punimit të diplomës nga studentit. Të gjitha informacionet lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimitMP ne “MarketingDixhital”, tëpërfshira në këto dokumente, ju bëhen të njohura studentëve para se tëregjistrohen dhe mbas kësaj nënshkruhet edhe kontratat e vazhdimit të studimeve me studentët.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i> <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë. pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i> <i>Evidenca 64: Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ,nga takimi i realizuar me stafine angazhuar në programin e studimit Master Profesionalne “MarketingDixhital”,me studentët e programit si dhe referuar RVB-së, konstaton se studentët informohen me tëgjithakriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe të diplomimit, nëpërmjet sekretarisë, departamentit dhe sektorit të shërbimit ndaj studentëve. Këto informacione studentët i marrin në fillim të semestrit të dytë, ndërsa përzgjedhja e temës së punimit bëhet para se të fillojëperiudha e praktikës profesionale.Tëgjitha këto kritere dhe procedura janë të sanksionuara në rregulloren e UMT-së.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i> <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon</p>	<p>Departamenti i Shencave Administrative si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimitMP ne“MarketingDixhital”, sektori i marketingut si dhe zyra e shërbimit ndaj studentëve, para fillimit të çdo viti akademik</p>

<p>udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>punojnë intensivisht për tërheqjen e kandidatëve potencialë pranë UMT-së, duke ndërmarrë një sërë veprimtarish informuese në rajone dhe qytete të ndryshme të Shqipërisë. Përmbajtja e këtyre veprimtarive konsiston në informimin e të interesuarve në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, mundësitë që krijon ai për punësim etj. Nga sa më sipër GVJ konstaton që kriteret plotësohen, institucioni është i pajisur me strukturat përkatëse si dhe me procedurat e rregulluara dhe zbatuara nga strukturat përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 88: Plani Marketingut-UMT. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, njësia bazëpërgjegjëse së bashku me dekanatin organizojnë takime informuese dhe të përshtatjes me fakultetin, ku atyre ju shpjegohen në detaje përbërja e UMT-së, struktura e tij, objektivat dhe strategjia, përbërja dhe struktura e Fakultetit të Ekonomisë, drejtuesit dhe stafi i tij, përgjegjësit e departamenteve etj. Gjithashtu behet edhe prezantimi me infrastrukturën, bibliotekën, laboratorët dhe kushtet në të cilat do të realizohet ky program studimi. Studentët mund të informohen edhe nëpërmjet planit mësimor për strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra të tyre.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë. pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik etj.</p> <p><i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet elëndëve. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni është i pajisur me struktura që krijojnë mundësinë për informimin e studentëve dhe lehtësojnë tranzicionin e tyre drejt tregut të punës. Zyra e këshillimit të karrierës dhe e shërbimit ndaj studentëve, informojnë, orientojnë dhe këshillojnë studentët për mundësitë e punësimit. Zyra e Karrierës dhe Alumnit është struktura përgjegjëse që</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

58




	<p>zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, ëorkshop-e, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë.</p> <p>Nga takimi GVJ me stafin e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit u konstatua që personeli i angazhuar ishte i motivuar për ti ofruar studentëve një shërbim sa më cilësor. Personeli në drejtim të kësaj zyre është trajnuar dhe disponon aftësitë profesionale. Aktivitetet kryesore të kësaj zyre kanë për qëllim të ndihmojë studentët në qartësimin e qëllimeve akademike dhe të karrierës, në krijimin e planeve të karrierës si dhe në zhvillimin e aftësive të kërkimit të punës dhe më pas është alumni, i cilinë rang institucionalsi UMT ka një rrjet që i gjurmon, ndërsa për programin e studimit MP në “Marketing Dixhital”, duke qenë se është viti i parë që është hapur, nuk ka alumni.</p> <p><i>Evidenca 77: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës. pdf</i>  <i>Evidenca 78: Aktivitetet e Zyrës së Karrierës. pdf</i>  <i>Evidenca 82: Rrjeti Alumni UMT. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në UMT, studentëve u vihet në dispozicion një informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Strukturat kryesore të komunikimit janë zyra e shërbimit të studentëve, këshilltarët akademik, departamenti, të cilat përdorin faqen e bërë, rrjetet informatike, botimet e ndryshme si dhe komunikimet gjore.</p> <p><i>Evidenca 36: Publikimi në ëeb të UMT_së të gjithë njoftimeve (linku përkatëse)</i>  <i>Evidenca 98: Detyrat dhe përgjegjësit e Këshillit Akademik</i>  <i>Evidenca 113: Axhenda e takimeve të Këshilltarve akademik-Semestri i parë</i>  <i>Evidenca 123: Axhenda e takimeve të Këshilltarve akademik-Semestri i dytë, online</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Sipas RVB-së dhe dokumentave të tjerë të paraqitur nga institucioni sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ofrohet studentëve në kohë dhe me cilësinë e kërkuar nëpërmjet platformave përkatëse si p.sh. <i>edu4school</i>. Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët edhe nëpërmjet postës elektronike dhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të UMT-së si dhe nga botime të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca 36: Publikimi në ëeb të UMT_së të gjithë njoftimeve (linku përkatëse. pdf</i>  <i>Evidenca 43: Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve. pdf</i>  <i>Evidenca 44: Manuale përdorimi të Sistemit informatik të studentëve. pdf</i>  <i>Evidenca 47: Print Screen të faqes ëeb lidhur me veprimtarinë kërkimore shkencore. pdf</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna sipas viteve për studentët që kanë aplikuar, numrin e studentëve që vazhdojnë studimet dhe studentëve të diplomuar për programet e tjera, ndërsa për programin e studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, në vitin akademik 2019-2020 rezultojnë të regjistruar 8 studente nga të cilët deri në momentin e vizitës në institucion asnjëri prej tyre nuk është diplomuar. Këto të dhëna ndodhen në sekretarinë mësimore dhe në regjistrat e zyrës së marrëdhënieve me studentët. Gjithashtu të dhënat në lidhje me studentët e regjistruar dhe të diplomuar, apo me kalueshmërinë sipas viteve gjenden edhe në raportet vjetore të çdo viti të FE-së, kupër këtë program studimi nuk është bërë akoma.</p> <p>Për çdo student sekretaria mësimore disponon dosjet e studentëve, të cilat përmbajnë të dhënat që nga regjistrimi, ndjekja e studimeve deri në përfundim me diplomimin e tyre.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi regjistrat themelor ku çdo student është regjistruar dhe është pajisur me numër matrikullimi. Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si: listë notash, kontrata, aneks kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, diploma e shkollës së mesme, diploma e studimeve të ciklit të parë, lista e notave dhe dy fotografi.</p> <p><i>Evidenca 73: Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar -FE. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat statistikore, për programin e studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, menaxhohen kryesisht nga sekretaria mësimore e FE-së. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të reregjistruar etj, bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e UMT-së. Statistikat e përgatitura ruhen në formë elektronike dhe hard-copy.</p> <p><i>Evidenca 95: Rregullore e sekretarisë mësimore. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna në lidhje me ecurinë e studentëve gjatë viteve akademike, të cilat grumbullohen dhe përpunohen nga sekretaria mësimore e UMT-së. Në përputhje me udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe të organeve drejtuese të UMT-së, këto të dhëna shënohen në regjistrin e tërhequr nga institucioni për matrikullimin e studentëve.</p>

	<p>Nëfund të çdo sezoni provimesh lektori i lëndës depoziton pranë sekretarisë së fakultetit proces verbalin me listën e studentëve dhe notat përkatëse si dhe një evidencë mbi pikët e fituara gjatë vitit në elementëte ndryshëm të kontrollit të dijeve si dhe pikët përfundimtare të marra në provim. Në bazë të këtyre të dhënave sekretaria mësimore bën pasqyrimin e notave nëregjistrate arritjeve akademike.</p> <p><i>Evidenca 95: Rregullore e sekretarisë mësimore. pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve të nxjerra ngasekretaria mësimore e UMT-së, menaxhohen dhe ruhen elektronikisht si edhe në dosje fizike nga personat e autorizuar.</p> <p>Të dhënat janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat ruhen konform akteve rregulluese të UMT-së.</p> <p><i>Evidenca 95: Rregullore e sekretarisë mësimore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Referuar RVB-së dhe dokumentacionit të depozituar në sistem, UMT-ja harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Në programin e studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, në vitin akademik 2019-2020 rezultojnë të regjistruar 8 studentë me një notë mesatare në hyrje 6.61. Për këtë program nuk ka raport për cilësinë në dalje të studentëve, pasi ky është viti i parë që zhvillohet mësimi në këtë program.</p> <p><i>Tabela 21: Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse</p>	<p>Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të UMT-së sipas rregullave ligjore në fuqi. Ata janë anëtar me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik.</p> <p>Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: Senatin Akademik të UMT dhe në komisione të përhershme si NJBSC. Studentët e Departamentit të Shkencave Administrative dhe veçanarisht ato të programit të studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital” janë pjesë e organeve drejtuese të UMT-së, në komisionin për garantimin e standardeve dhe cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Në statutin e UMT-së dhe rregulloret e ndryshme garantohet e drejta e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

61




<p>dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>akademik. Studentët e UMT-së, përfshirë këtu edhe studentët e programit të studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital” nëpërmjet vlerësimeve semestrale, apo dhe në forma të tjera, shprehin mendimet e tyre, lidhur me procesin e mësimdhënies, mësimnxënies si dhe punën e personelit akademik të fakultetit dhe të departamentit në çdo kohë të vitit.</p> <p><i>Evidenca 8: Përbërja e NJSBC-së</i>  <i>Evidenca 12: Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT-së</i>  <i>Tabela 24: Të dhëna për anëtarët e NJSBC-së</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Nërregulloren e UMT-së, në rregulloren e FE-së si dhe nërregullorene programit të studimit MP ne “Marketing Dixhital” është parashikuar ngarkesa akademike e studentëve për të gjitha programet e studimit si dhe për programin që po akreditohet. Programi i studimit parashikon njohjen e studimeve të pjeshme apo të plota të kryera më parë duke u bazuar në ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, në urdhëra dhe udhëzime të ndryshme të Ministrisë së Arsimit.</p> <p>Sipaskritereve të parashikuara nërregullorene UMT-së, institucioni mund tu njohë studentëve të masterit profesional kredite që ato të mund të kalojnë në master shkencor, bazuar në përputhshmërinë midis dy kurikulava dhe syllabusve të lëndëve.</p> <p>Departamenti here pas here rishikon programet e studimit dhe syllabuset e lëndëve me qëllim që njohuritë ti përshtaten në mënyrë sa më të plotë me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana</i>  <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ, konstaton që institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Tërheqja e mendimeve bëhet nga departamenti si dhe gjatë diskutimit të planeve mësimore në fazat e miratimit të tyre si dhe në fund të semestrit kur analizohen aftësitë dhe kompetencat e marra gjatë lëndës dhe problemet që janë evidentuar. Kjo përfshirje e studentëve parashikohet në statutin e UMT-së, rregulloren e UMT-së, në rregulloren e FE dhe të departamentit si dhe nërregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 50: Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë. pdf</i>  <i>Evidenca 58: Rregullore e programit të studimit. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit</p>	<p>Institucioni në rregulloren e tij si dhe në rregulloren e provimeve, ka parashikuar procedurën që siguron ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë këtu mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njësisë dhe pedagogut përgjegjës.</p>




nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<i>Evidenca 63: Rregullore e provimeve. pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ, konstaton se, institucioni është pajisur me struktura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Nëpërputhje me aktet ligjore dhe ato rregullatore të UMT-së, në shërbim të informimit e kujdesit ndaj studentëve funksionojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyra e informimit dhe e këshillimit të karrierës, e cila merret me informimin e studentëve që nga moment i ardhjes së tyre dhe gjatë të gjithëperiudhës së shkollimit;</li> <li>• Zyra e shërbimit ndaj studentit, e cila informon studentët dhe ndjekë shqetësimet e tyre, duke ju dhënë përgjigje studentëve brenda afateve të përcaktuara për zgjidhjen e tyre.</li> <li>• Këshilltarët akademik japin informacione rreth zhvillimit të procesit mësimor dhe nevojave të tjera të studentëve.</li> <li>• Departamenti i Shkencave Administrative, i cili është përgjegjës për realizimin e programit të studimit MPne “Marketing Dixhital”.</li> <li>• Sekretaria mësimore e FE-së, është në shërbim të studentëve për të dhënë informacione nevojshme apo për ti ndihmuar ata në lidhje me proceduratë regjistrimit apo lëshimin e vërtetimeve të ndryshme të kërkuara nga studentët.</li> </ul> <p>UMT-ja, më vendim rektorati, ka ngritur organizimin e tutoriatit, i cili ka si qëllim mbështetjen e studentëve në lidhje me problemet që mund të paraqiten gjatë viteve të studimit në të gjitha ciklet e studimeve (bachelor dhe master), gjë që synon rritjen e nivelit të performances të studentëve dhe maksimizimin e efektit të punës së tyre.</p> <p>Në lidhje me këshillimin e karrierës, GVJ është e mendimit se Zyra e Marredhenieve me Publikun dhe Marketingut, ALUMNI dhe e Karrierës, organizon në mënyrë të vazhdueshme aktivitete informuese dhe orientuese në lidhje me punësimin e tyre të ardhshëm.</p> <p>Sektori i Marketingut i UMT-së ndjek të gjithë studentët që kane përfunduar studimet në programet e tjera të këtyre universiteti, pasi programi i studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, që po akreditohet, nuk ka studentë ALUMNI, pasi është viti i parë që po</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

63

	zhvillohet.  <i>Evidenca 77: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës. pdf</i> <i>Evidenca 78: Aktivitetetë Zyrës së Karrierës. pdf</i> <i>Evidenca82: Rrjeti Alumni UMT. Pdf</i> <i>Evidenca 95: Rregullore e sekretarisë mësimore. pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni është i pajisur me strukturat që garantojnë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së brendshme duke përfshirë edhe programin MP ne “MarketingDixhital”.Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Funksioni i kësaj njesie është në përputhje të plotë të misionit të institucionit. NJSBC si strukturë, është e paraparë në Statutin e UMT-së,me detyrime të qarta dhe të plota,bazuar në nenin 103 të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartëdhe Kërkimin Shkencornë Republikën e Shqipërisë”.  <i>Evidenca 1: Statuti i UMT-së. pdf</i> <i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Në nivel institucional përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.Monitorimi i sigurimit të cilësisë funksionon edhe në rang fakulteti, kur kjo kërkohet nga dekani ose rregulloret institucionale. Kjo njësi monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor.  <i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

64






	<i>Evidenca 71: Model i vlerësimit të performanceës së pedagogëve. pdf</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	UMT përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.			
	<i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në rregullore. Në mënyrë periodike NJSBC-jaraporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesoredhe përmes tyre të gjithë stafin e UMT-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara në rregulloren e cilësisë dhe akte të tjera të UMT-së. Zbatimi i standardeve të cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, infrastrukturore, etj me qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor.			
	<i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	NJSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm përveç NJSBC-së ka dhe Departamenti i Shkencave Administrative, si njësi përgjegjëse për programin e studimit MP ne “MarketingDixhital”.
	<i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Referuar RVB-së, NJSBC-ja përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese. Gjithashtu, Fakulteti i Ekonomisë bashkëpunon me drejtuesit dhe specialistët e NJSBC-së, me qëllim mbikëqyrjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Monitorimi i realizimit të programit kryhet në mënyrë të vazhdueshme

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

65




	<p>nga Departamenti i Shkencave Administrative dhe Fakulteti i Ekonomisë, të cilët kryejnë analizat vjetore dhe vlerësimin e brendshëm në përputhje me rregulloren UMT-së.</p> <p><i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>  <i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC-së për pyetësorët e stafit akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 11: Modeli i pyetësorit për studentët. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>NJSBC-ja përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike.</p> <p>Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga NJSBC-ja dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu, departamenti përgjegjës për programin dhe Fakulteti i Ekonomisë realizojnë vlerësimin e ecurisë së mbarëvajtjes së programeve të studimit. Për realizimin e vlerësimit përdoren disa metoda si: pyetësorë me studentët, inspektime gjatë orëve të mësimin në auditor nga përgjegjës i departamentit dhe nga përfaqësues të NJSBC-së.</p> <p>Departamenti dhe NJSBC-ja përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme për ecurinë e treguesve të cilësisë si, treguesit për vlerësimin e programit, treguesit për vlerësimin e lëndës, treguesit për vlerësimin e procesit mësimor dhe të pedagogut, tregues për gjendjen e infrastrukturës etj.</p> <p>Gjithashtu, sekretaria mësimore mban të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me arritjet e studentëve dhe të dhëna të ndryshme për to, të tilla si: arritjet e studentëve, karakteristika demografike të studentëve, vlerësimin e kërkesave të studentëve sipas shqetësimeve dhe programeve, qarkullimin e studentëve, ardhjet, largimet etj.</p> <p><i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>  <i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC-së për pyetësorët e stafit akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 11: Modeli i pyetësorit për student. pdf</i>  <i>Evidenca 115: Procesverbal i kontrollit në auditore. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB-së, rezultatet e vlerësimit, përpunohen nga NJSBC-ja dhe departamentet përkatëse, ku në rastin e programit MP ne “Marketing Dixhital”, përpunohen nga Departamenti i Shkencave Administrative. Raporti i përmbledhur nga NJSBC-ja shkon për diskutim në departament, dekanat dhe rektorat. Pasi analizohet ky raport, dalin konkluzionet përkatëse lidhur me mënyrën e zgjidhjes së problematikave dhe përmirësimin nëpërmjet korrigjimit nga ana e të gjithë aktorëve të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC-së për pyetësorët e stafit akademik. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Referuar RVB-së dhe dokumentacionit në sistemin AMS, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit bazohen në krahasimin e rezultateve të pritshme me ato të vlerësimit të konstatuar si dhe në masat e marra për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Rezultatet a dala nga raportet e vlerësimit përfshijnë tregues të performancës së pedagogëve, rezultatet e mësimnxënies, si dhe tregues</p>




	të tillë si: ruajtja dhe rritja e nivelit të regjistrimeve, nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, nivelet e punësimit, diversiteti i kërkesave nga studentët sipas profileve, ndërkombëtarizimi i universitetit, etj.			
	<i>Evidenca 71: Model i vlerësimit të performancës së pedagogëve. pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit.  <i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i> <i>Evidenca 73: Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar – FE, 2018 -2019. pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Sipas RVB-së, institucioni ndërmerr analiza të vlerësimit të cilësisë në disa drejtime. Kështu ai përdor instrumente të ndryshme për vlerësimin e cilësisë si analiza dhe përpunimi i raporteve dhe proces verbaleve të kontrollit në auditor, kontrollet e natyrave të tjera si dhe raporti vjetor i hartuar nga fakulteti dhe departamenti përgjegjës.  <i>Evidenca 73: Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar – FE, 2018 -2019. pdf</i> <i>Evidenca 115: Procesverbal i kontrollit në auditore. pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, teste	Sipas RVB-së dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem, GVJ konstaton se në UMT dhe në Fakultetin e Ekonomisë, si njësia kryesore ku zhvillohet programi i studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital”, mbarëvajtja e zbatimit të standardeve të cilësisë, realizohet nëpërmjet metodave të drejtpërdrejta si: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet verifikimit dhe kontrollit të procesit duke filluar që nga literatura e deri tek metodika e dhënies nga pedagogu.</li> <li>• Verifikimi i materialeve didaktike të lëndës që u vihet në dispozicion studentëve si literatura e zgjedhur, poëer point,</li> </ul>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

67

<p>lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>literatura ndihmëse, mjetet etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Verifikimi i kurrikulës që në momentin e hartimit të saj dhe deri tek ndjekja e zbatimit të saj hap pas hapi.</li> <li>• Verifikimi i procesit të përvetësimit të njohurive nga studentët, mundësia e të mësuarit dhe koha në dispozicion.</li> <li>• Vlerësimi i provimeve me objektivitet dhe në mënyrë të tillë që teza të paraqesë standardin e duhur për cilësinë e diplomës së kërkuar.</li> <li>• Vëzhgime të herëpashershme në auditor lidhur me realizimin e ushtrimeve praktike dhe të metodave të marketingut dixhital etj.</li> </ul> <p><i>Evidenca 54: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese pdf</i>  <i>Evidenca 55: Plani mësimor pdf</i>  <i>Evidenca 56: Plan programet e lëndëve. Pdf</i>  <i>Evidenca 63: Rregullore e provimeve</i>  <i>Evidenca 115: Procesverbal i kontrollit në auditore. pdf</i>  <i>Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese pdf</i>  <i>Tabela 10: Plani mësimor pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Të dhënat e siguruara nga NjBSC-ja, përmes sistemit të saj të informacionit përfshijnë: ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit, mundësitë dhe nivelet e punësimit të të diplomuarve, raportin pedagog-studentë, plotësimin e kërkesave të studentëve me programet e tyre, efektivitetin e pedagogëve, nivelin e largimit apo të transferimit të studentëve, treguesit kyç të performancës së institucionit etj.</p> <p>Gjitashtu GJV konstaton se, institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ. Në rastin e programit të studimit MP ne “Marketing Dixhital”, janë pyetur vetëm studentët aktualë, pasi është viti i parë i studimit.</p> <p>Departamenti i Shkencave Administrative dhe Fakulteti i Ekonomisë pranë UMT-së, nëpërmjet metodave dhe instrumenteve të tërthorta nxjerrin konkluzione lidhur me cilësinë, për të ndikuar më pas në përmbushjen e standardeve të saj.</p> <p><i>Evidenca 77: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës .pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>




<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në të gjitha rregulloret si në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti është parashikuar angazhimii të gjitha palëve të interesuar në realizimin e procesit mësimor cilësor. Kështu në UMT, pedagogët janë jo vetëm realizuas të procesit mësimor, por edhe si një faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të cilësisë duke u angazhuar në përpunimin e rregulloreve dhe standardeve të ndryshme të cilësisë. Gjithashtu, përfaqësimi i studentëve është instrument i rëndësishëm që realizohet në mënyra të ndryshme, si tërheqja e mendimit nga këshilltarët akademikë, përfaqësimin e tyre në senat dhe në organe të tjera vendimmarrëse të institucionit.</p> <p>Studentët janë pjesëmarrësedhenë NJSBC, ku në rregulloren e kësaj njësie, janë parashikuar detyra konkrete për njësitë, individët, studentët, pedagogët dhe palë të tjera të angazhuara për garantimin e cilësisë së programit të studimit. Kjo rregullore garanton përfshirjen e anëtarëve të personelit akademik dhe administrativsi dhe të studentëve. Ky funksion realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione, si p.sh. komisioni për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet ngritjessë grupit të punës për vlerësimin e brendshëm, etj.</p> <p><i>Evidenca 1: Statutii Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 2: Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana. pdf</i>  <i>Evidenca 9: Rregullore e NJSBC-së. pdf</i>  <i>Evidenca 10: Analizë e NJSBC-së për pyetësorët e stafit akademik.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja e aktorëve të brendshëm siguron dhe respekton integritetin akademik si të pedagogëve ashtu edhe të studentëve. Bazuar në RVB, GVJ, konstaton se UMT, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Shkencave Administrative, garantojnë integritetin akademik dhe në praktikë të tyre nuk janë konstatuar raste të diskriminimit, të pabarazisë kundrejt stafit akademik dhe studentëve apo të dallimeve subjektive.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së proceseve që lidhen me programet e studimit parashikon edhe përfshirjen e palëve të treta të cilat me ekspertizën e tyre mund të japin mendime për përmirësimin e cilësisë së programit. GVJ nga shqyrtimi i evidencave konstatoi angazhimin e ekspertëve të jashtëm në procesin vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë. Ekspertiza e tyre ka qenë e vlefshme sidomos në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. Mendimi i ekspertëve është tërhequr jo vetëm nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie, por edhe në takime të ndryshme, në konferenca shkencore, ëorë-shope etj.</p> <p><i>Evidenca 22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete. pdf</i>  <i>Evidenca 23: Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FE. pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>




Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>UMT publikon të gjitha rregulloret, statutin, rregulloren e funksionimit të NJSBC, kurrikulat, planin strategjik, kalendarin akademik dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e cilësisë, gjë që rrit shkallën e transparencës së institucionit në kuadrin e veprimtarive të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Studentëve të rinj, ju shpjegohet e gjithë procedura e mësimdhënies dhe mësimnxënies, rëndësia e cilësisë për UMT-në si instrument konkurrues dhe si vlerë e tij si dhe ju shpjegohet, objektivi dhe rëndësia e çdo programi studimi nga përgjegjësit e njësive bazë.</p> <p>Gjithashtu, Rektoratit dhe NJSBC-ja, çdo vit raportojnë mbi realizimin e objektivave të vitit të kaluar dhe objektivat për vitin e ardhshëm lidhur me cilësinë e procesit mësimor dhe kërkimor, procedurë kjo që realizohet edhe nga fakulteti dhe departamentet dhe që shërben për të informuar studentët dhe gjithë stafin dhe strukturat e tjera me problematiken e shfaqur në lidhje me cilësinë.</p> <p><i>Evidenca 112: Vendim për përcaktimin e Këshilltarëve akademik. pdf</i>  <i>Evidenca 113: Axhenda e takimeve të Këshilltarëve akademik-Semestri i parë. pdf</i>  <i>Evidenca 123: Axhenda e Këshilltarëve Akademik-Semestri i dytë, online. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni publikon dhe bën transparente rezultatet e vlerësimit bazuar në rregulloret përkatëse nëpërmjet formave të ndryshme të tilla si takime të ndryshme me grupet e interesit, studentë, studentët ALUMNI, grupe specialistësh të fushës përkatëse etj. Programi i studimit Master Profesional në “Marketing Dixhital”, duke qënë një program i hapur në vitin akademik 2019-2020 ende nuk është vlerësuar pas miratimit të tij në fazën e parë.</p> <p>UMT publikon e rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit si dhe të gjithë informacionin që disponon për këtë qëllim. Publikimi bëhet nëpërmjet shpërndarjes në hard copy të analizave të cilësisë për aktorët e UMT-së dhe takimeve formale me ta, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për arsimin e lartë.</p> <p>Programi i transparencës në UMT-së, është i lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore që parashikon neni 7 i ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe shikohet si një nevojë për të rritur shkallën e integritetit të stafit dhe përgjegjshmërinë institucionale të universitetit. Publikimi i informacionit bëhet në faqen on line në adresën:  <a href="http://www.umt.edu.al">www.umt.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e</p>	<p>Referuar RVB-së, rezultojnë se në UMT, analizat dhe raportet e ndryshme në lidhje me cilësinë dhe standardet e mësimdhënies dhe mësimnxënies i shoqëron me plane masash për të përmirësuar problemet e konstatuara.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

70




dobësive të evidentuara.	Për sa i përket programit të studimit Master Profesional ne “Marketing Dixhital”, nuk ka pasur vlerësime tërësore, por në vlerësimet e standardeve të veçanta gjatë vitit të parë të aplikimit të tij, është proceduar me korrigjimet e nevojshme në procesin e mësimit, si dhe në diskutimin e përmbajtjes dhe mënyrës së zhvillimit të lëndëve me karakter aplikativ.			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Departamenti i Shkencave Administrative, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional ne “Mrketing Dixhital”, synon realizimin e objektivave të cilësisë, duke arritur përmirësimin dhe duke reflektuar hap pas hapi në zgjidhjen e çdo problemi të konstatuar. Institucioni e vlerëson efektivitetin e programit të lidhur ngushtë me aftësimin e studentëve për të realizuar objektivat dhe pritshmëritë e tyre në përfundim të kursit.</p> <p>Një nga funksionet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë është të komunikojë rezultatet dhe të ndërgjegjësojë palët e ndryshme të interesit për hapat e ndërmarra për rritjen e cilësisë në të gjitha drejtimet. Lidhur me këtë Departamenti i Shkencave Administrative dhe FE, pranë UMT-së, organizojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe në periudha të ndryshme kohore, aktivitete me personelin akademik dhe ndihmës akademik përmes mbledhjeve të hapura të asamblesë, takimeve me studentët për ndërgjegjësimin e tyre për nevojën e përmirësimin të cilësisë si në afat shkurtër dhe afat gjatë.</p> <p>GVJ, vëren se, UMT-ja i kushton vëmendje edhe ndërgjegjësimin të studentëve dhe personelit akademik për nevojën e sigurimit te standardeve të larta të cilësisë. Në nivel departamenti janë organizuar aktivitete të ndryshme informuese me studentët të të gjitha cikleve dhe të këtij programi në funksion të nevojës për plotësimin sa më të mirë të cilësisë, si kusht që diploma dhe njohuritë e tyre të jenë të vlefshme, bashkëkohore dhe afat gjata.</p> <p>Objektiv i rëndësishëm ka qene jo vetëm informimi dhe pjesëmarrja e studentëve dhe pedagogëve në procesin e ndërgjegjësimin, por edhe pjesëmarrja e tyre në përmirësimin e cilësisë së programeve të mësimit.</p> <p><i>Evidenca 113: Axhenda e takimeve të Këshilltarëve akademik-Semestri i parë. pdf</i>  <i>Evidenca 123: Axhenda e Keshilltarëve Akademik-Semestri i dytë, online. Pdf</i>  <a href="http://www.umt.edu.al">www.umt.edu.al</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Marketing Dixhital” të institucionit të arsimit të lartë Universiteti “Metropolitan Tirana”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit MP “Marketing Dixhital” përbën një inovacion jo vetëm për Universitetin Metropolitan Tirana që e ofron, por për të gjithë tregun e arsimit të lartë shqiptar, si publik ashtu edhe privat, pasi është vetëmi program studimi që ofrohet në fushën e marketingut dixhital në vend.
2. Ofrimi i lëndëve me pedagogë të huaj, profesionistë të fushës, iu mundëson studentëve metodat më inovative të mësimdhënies, aftësi e kompetenca profesionale jo vetëm për tregun e punës në nivel kombëtar por dhe në atë ndërkombëtar.
3. Vendodhja gjeografike dhe pozicionimi në një zonë studentore, mundëson qasjen prane një tregu më të madh të synuar.
4. Tregu aktual ndërkombëtar dhe kombëtar dikton rritje të nevojave për diploma të tilla në treg.
5. Mundësi për punësim të studentëve që priten të diplomohen në këtë program studimi.
6. Marreveshjet e bashkëpunimit dhe referimi tek ndërkombëtares, apo e gjithë qasja ndërkombëtare përbën një instrument që mbështet inovacionin e këtij programi studimi në vijshmërinë e rrugëtimit sipërmarrës dhe inovativ të UMT.

**Pika të dobëta:**

1. Mungesa e një studimi tregu të detajuar për programin e studimit në fjalë.
2. Numri i kufizuar i literaturës hard copy dhe elektronike në funksion të këtij programi studimi.

**Rekomandime:**

1. Institucioni, të realizojë studime të tregut të punës të detajuara, bazuar në studime/ kërkime sasiore dhe në analiza të detajuara të bizneseve që ofrojnë shërbime të cilat kanë lidhje me programin e studimit.
2. Shtimi i fondit të bibliotekës me literaturë hard copy dhe elektronike që ka lidhje me programin e studimit.
3. Bashkëpunim më të madh me tregun vendas, bizneset që operojnë aktualisht në tregun e shërbimeve dixhitale dhe ato të marketingut elektronik.
4. Rishikim dhe përditësimi i syllabuseve të lëndëve me qëllim: mos persëritjen e koncepteve, eliminimin e temave të panevojshme apo përsëritura, si dhe përfshirjen e më shumë elementëve praktik në ato lëndë që kanë ngarkesë tëmadhe të leksioneve në auditor.
5. Rekomandohet të përfshihendisa lëndë me zgjedhje që synojnë formime specifike si dhe nje apo dy lëndëtë përgjithshme marketing. Kjo mund tërealizohet duke zvogëluar numrin e krediteve dhe shpërndarë në tërësi kreditet midis lëndëve.





**Conclusions of the evaluation of the second cycle study program, Professional Master in  
“Digital Marketing” of the “Metropolitan University of Tirana”**

**Strengths and Affirmations:**

1. The study program PM in "Digital Marketing" is an innovation not only for the Metropolitan University of Tirana that offers it, but for the entire Albanian higher education market, both public and private, as it is the only study program offered in the field of digital marketing in the country.
2. Offering courses with foreign professors, professionals in the field, enables students the most innovative teaching methods, skills and professional competencies not only for the labor market at the national level but also internationally.
3. Geographical location and positioning in a student area, enables access to a larger target market.
4. The current international and national market dictates the growing need for such degrees in the market.
5. Employment opportunities for students expected to graduate in this study program.
6. Cooperation agreements and referral to internationals, or the entire international approach is an instrument that supports the innovation of this study program in the continuation of the entrepreneurial and innovative journey of UMT.

**Weaknesses:**

1. Lack of a detailed market study for the study program in question.
2. Limited number of hard copy and electronic literature in function of this study program.

**Recommendations:**

1. The institution, to conduct detailed labor market studies, based on quantitative studies / research and detailed analysis of businesses that provide services that are related to the study program.
2. Increasing the library fund with hard copy and electronic literature related to the study program.
3. Greater cooperation with the local market, businesses that currently operate in the market of digital services and those of electronic marketing.
4. Reviewing and updating course syllabi in order: not to repeat concepts, eliminate unnecessary or repetitive topics, as well as include more practical elements in those courses that have a large load of lectures in the auditorium.
5. It is recommended to include some elective courses aimed at specific formations as well as one or two general marketing courses. This can be achieved by reducing the number of credits and distributing the credits as a whole among the subjects.



## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X


